



GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË
.....
Nr. 1 / 17 JANAR 2013

**LIGJI NR. 04/L-120
PËR MBROJTJEN E BIMËVE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR MBROJTJEN E BIMËVE

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Ky ligj rregullon të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me:

- 1.1. mbrojtjen e bimëve, të produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përfshira në prodhimtarinë bimore;
- 1.2. përcaktimin e masave për parandalimin e hyrjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm në bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera dhe për zhdukjen e tyre;
- 1.3. lehtësimin e mbledhjes dhe këmbimit të informatave dhe të dhënave me vende të tjera;
- 1.4. financimin dhe kompensimin për punët e kryera në lëmin e mbrojtjes së bimëve;
- 1.5. përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të subjekteve të përfshira në mbrojtjen e bimëve dhe zbatimin e këtij ligji në Kosovë.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Ky ligj siguron kushtet për:

- 1.1. mbrojtjen e bimëve dhe produkteve bimore nga organizmat e dëmshëm;
- 1.2. parandalimin e futjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm dhe zhdukjen e tyre;
- 1.3. identifikimin e organizmave të dëmshëm;
- 1.4. prodhimtari optimale dhe qarkullimin e bimëve dhe produkteve bimore;
- 1.5. zbatimin e mbikëqyrjes së përhershme të organizmave të dëmshëm, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve të tyre, zbatimin e masave për mbrojtjen e bimëve dhe kryerjen e detyrave dhe raporteve të tjera;
- 1.6. orientimin dhe monitorimin e zhvillimit të veprimtarive lidhur me mbrojtjen e bimëve;
- 1.7. mbledhjen, ruajtjen dhe këmbimin e të dhënave dhe informatave;
- 1.8. edukimin e popullatës dhe ngritjen e vetëdijes së saj lidhur me mbrojtjen e bimëve.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Deklarim plotësues** - deklaram i cili kërkohet nga një vend importues ku malli duhet të futet me një Certifikatë Fitosanitare, me të dhëna plotësuese specifike për një dërgesë lidhur me organizmat e dëmshëm të rregulluar me këtë ligj;
- 1.2. **Mall** - lloj bime, produkti bimor ose artikull tjetër i cili qarkullohet për tregti apo qëllime të tjera;
- 1.3. **Organ kompetent** – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Departamenti për politika bujqësore, tregjet dhe i tregtisë;
- 1.4. **Dërgesë** - një sasi bimësh, produktesh bimore dhe objektesh të tjera të cilat lëvizin nga një vend në një tjetër dhe shoqërohen, kur kërkohet, me një certifikatë të vetme fitosanitare, ku një dërgesë mund të përbëhet nga një apo më shumë mallra apo ngarkesa;
- 1.5. **Dërgesë në transit** - një dërgesë e cila kalon nëpër një vend pa u importuar dhe që mund t'u nënshtrohet kontrolleve fitosanitare të cilat sigurojnë që dërgesa të mbetet e mbyllur, të mos ndahet, apo kombinohet me ngarkesa të tjera dhe as t'i ndryshohet paketimi;
- 1.6. **Vend i origjinës** - vendi në të cilin janë kultivuar bimët dhe nga të cilat janë përfituar produktet bimore;
- 1.7. **Eksport** - transport i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve me origjinë nga Kosova në vende të tjera;
- 1.8. **Organizma të dëmshëm - parazitë e patogjenë** të bimëve apo produkteve bimore, të cilat i përkasin botës bimore apo shtazore ose viruse, fitoplazma apo patogjenë të tjerë;
- 1.9. **Vlerësim i organizmave të dëmshëm** - procedurë zyrtare e grumbullimit, ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave mbi praninë e organizmave të dëmshëm në bimë, në bazë të përcjelljes së gjendjes shëndetësore, të hulumtimeve sistematike, kontrollit inspektues apo procedurave të tjera si dhe të dhënave plotësuese;
- 1.10. **Import - çfarëdo futje** e dërgesave në pikat hyrëse të Kosovës, pa marrë parasysh destinimin e tyre sipas Ligjeve Doganore, përveç kalimit transit;
- 1.11. **Leje Importi** - dokument zyrtar i cili autorizon importin e një malli në përputhje me kërkesat specifike fitosanitare për import;
- 1.12. **Inspektim** - kontrolli vizual zyrtar i bimëve , produkteve bimore apo objekteve të tjera për të përcaktuar praninë ose jo të organizmave të dëmshëm për të përcaktuar nëse janë përmbushur rregullat fitosanitare;
- 1.13. **Inspektor** - person i autorizuar nga Ministria për zbatimin e këtij ligji;
- 1.14. **Hyrje** - hyrje e një organizmi të dëmshëm në zona në të cilat prania e tyre nuk ka qenë e vërtetuar më parë dhe që rezulton i pranishëm;
- 1.15. **Listë e organizmave të dëmshëm** - listë e organizmave të dëmshëm, hyrja dhe përhapja e të cilave është e ndaluar apo e trajtuar me këtë ligj;
- 1.16. **Ngarkesë** – numër i njësisive të një malli të vetëm të identifikueshëm për nga homogjeniteti i përbërjes, origjinës, etj. si pjesë të një dërgese;
- 1.17. **Ministria** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- 1.18. **Monitorim** - proces zyrtar i vazhdueshëm për verifikimin e situatave fitosanitare;
- 1.19. **Kontroll zyrtar** - zbatim aktiv i ligjeve dhe akteve nënligjore fitosanitare dhe zbatim i procedurave të detyrueshme fitosanitare me objektiv zhdukjen ose kufizimin e veprimit të organizmave të dëmshëm karantinorë ose menaxhimin e parazitëve jo karantinorë që trajtohen në këtë ligj, që përfshin:
 - 1.19.1. zhdukjen ose kufizimin e tyre në zonat e infektuara;
 - 1.19.2. mbikëqyrjen në zonat e rrezikuara; dhe
 - 1.19.3. masat lidhur me kontrollet e lëvizjeve drejt e brenda zonës apo zonave të mbrojtura, përfshirë

masat që aplikohen në importim.

1.20. **Objekte të tjera** - vende, pajisje për ruajtje, trajtime, përpunime të bimëve dhe produkteve bimore, materiale paketimi, mjete transportuese, kontejnerë, apo materiale të tjera që përdoren për kultivimin e bimëve dhe organizmave të tjerë, mjete dhe materiale të cilat mund të përmbajnë dhe bartin organizma të dëmshëm për bimët që u nënshtrohen masave fitosanitare;

1.21. **Organizëm i dëmshëm** - çdo lloj apo biotip bimor, shtazor ose agjent patogjen i dëmshëm për bimët ose produktet bimore;

1.22. **Analizë e rrezikut të Organizmave të dëmshëm** - procesi i vlerësimit të të dhënave biologjike apo i të dhënave të tjera shkencore dhe ekonomike për të përcaktuar nëse një organizëm është i dëmshëm dhe nëse duhet të trajtohet në ligj dhe shkallën e rreptësisë së masave fitosanitare që merren kundër tij;

1.23. **Vlerësim i rrezikut nga organizmat e dëmshëm** – vlerësim i probabilitetit të hyrjes dhe përhapjes të një organizmi të dëmshëm dhe i madhësisë së pasojave të mundshme ekonomike që bart;

1.24. **Menaxhimi i rrezikut nga organizmat e dëmshëm** - vlerësim dhe zgjedhja e rrugëve të ndryshme për të ulur rrezikun e hyrjes dhe përhapjes së një organizmi të dëmshëm;

1.25. **Certifikatë Fitosanitare** - dokument zyrtar i cili vërteton gjendjen fitosanitare të çdo dërgese që i nënshtrohet ligjeve fitosanitare dhe e cila shoqëron dërgesat e bimëve për eksport, të importuara apo në kalim transit;

1.26. **Masa fitosanitare** – çdo ligj, akt nënligjor apo procedurë zyrtare që ka për qëllim të parandalojë hyrjen ose përhapjen e organizmave të dëmshëm karantinorë ose të kufizojë pasojat ekonomike të organizmave të dëmshëm jo karantinorë që trajtohen në këtë ligj;

1.27. **Inspekcioni Fitosanitar** – organi përgjegjës për inspektimin e dërgesave bimore gjatë import-eksportit të tyre dhe për kontrollin e territorit nëpërmjet inspektorëve fitosanitarë;

1.28. **Legjislacioni Fitosanitar** - ky ligj dhe çdo akt nënligjor, rregulloret, udhëzimet apo tjetër vendim administrativ i nxjerrë nga ministria si edhe kontratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare për mbrojtjen e bimëve;

1.29. **Vendi i prodhimit** – çdo vend apo grupim tokash e trajtuar si njësi e vetme prodhimi apo fermë që mund të përfshijë vendet e prodhimit të cilat menaxhohen të veçuara për qëllime fitosanitare;

1.30. **Produkte bimore – produkte të papërpunuara me** origjinë bimore si drithëra dhe produkte të përpunuara, të cilat falë natyrës së tyre apo përpunimit, mund të krijojnë rrezik për hyrjen dhe përhapjen e organizmave të dëmshëm. Produktet bimore përfshijnë edhe drurin nëse ai e ruan sipërfaqen e tij në kushte natyrore ose pjesë të tij, me apo pa lëvore, të përpunuara në formë të pllakave të prera, pjesëza, tallash, mbetje ose copëza, dru i gdhendur, material ambalazhi druri, material paketimi prej druri të përpunuar që përdoret për transportimin e dërgesave të ndryshme;

1.31. **Pasaportë bimore** – dokumenti i lëshuar nga organi kompetent ku dëshmohet se janë përmbushur standardet e shëndetit të bimëve dhe kërkesat specifike në fuqi për bimët dhe produktet bimore brenda territorit të Kosovës;

1.32. **Karantinë bimore** - të gjitha veprimtaritë e përcaktuara për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen e organizmave të dëmshëm karantinorë apo sigurimin e kontrollit zyrtar të tyre;

1.33. **Bimë** - bimë të gjalla ose pjesë të tyre të gjalla duke përfshirë frytin në kuptim botanik me përjashtim të atyre që ruhen me ngrirje të thellë, perimet, tuberë, bulbe, rizoma, lule të prera me ose pa gjemba, degë me gjethe, degë të prera me gjethe si, kultura indore bimore, micel i kërpudhave dhe polen i gjallë, farëra dhe gjermoplazmën;

1.34. **Bimë për mbjellje** - bimë të përcaktuara të mbeten të mbjellura apo rimbjellura;

1.35. **Pikë e hyrjes** – Aeroport ose pikë kufitare tokësore e përcaktuar zyrtarisht për importimin e dërgesave, ku inspektori fitosanitar në bashkëpunim me kontrollin Doganor janë të autorizuar të kontrollojnë dërgesa të

importuara, eksportuara ose rieksporuara;

1.36. **Prodhues në bujqësi** - personi fizik apo juridik i cili është pronar, apo merret me prodhimin, përpunimin, trajtimin, ruajtjen, tregtimin, shpërndarjen apo ndonjë përdorim tjetër të bimëve dhe produkteve bimore;

1.37. **Certifikatë për Riekспорт** – certifikatë që lëshohet për dërgesat që rieksporthen mbasi që inspektimet zyrtare kanë siguruar se në dërgesën e re nuk ka rreziqe fitosanitare;

1.38. **Dërgesë e rieksportuar** – dërgesë e cila ka qenë importuar në një vend nga i cili më pas është eksportuar. Dërgesa mund të ruhet, ndahet, kombinohet me dërgesa të tjera ose t'i ndryshohet paketimi - drejt vendit të rieksportit;

1.39. **Regjistrim** – akti i miratimit të aktivitetit të prodhimit të bimëve dhe produkteve bimore nga organi kompetent;

1.40. **Territor nën trajtim ligjor** - një zonë në të cilën, brenda së cilës dhe nga e cila bimët, produktet bimore dhe artikuj të tjerë të trajtuar në këtë Ligj ju nënshtrohen rregulloreve fitosanitare apo procedurave në mënyrë që të parandalohen hyrja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm karantinorë ose që të kufizohet ndikimi ekonomik i organizmave të dëmshëm jo karantinorë që rregullohen me këtë ligj ;

1.41. **Farëra** – farëra për t'u mbjellë apo që destinohen për mbjellje dhe jo për konsum apo përpunim;

1.42. **Mbikëqyrje** – proces zyrtar gjatë të cilit grumbullohen dhe mbahen shënime të dhëna mbi shfaqjen e organizmave të dëmshëm apo mungesën e tyre nëpërmjet shqyrtimeve, monitorimit apo procedurave të tjera;

1.43. **Provë** – kontroll zyrtar, jo vizual për të përcaktuar nëse organizmat e dëmshëm janë të pranishëm ose për të identifikuar organizmat e dëmshëm;

1.44. **Transferim – çfarëdo** transferim i bimëve, produkteve bimore, materialeve dhe objekteve të tjera jashtë vendit të prodhimit brenda territorit të Kosovës;

1.45. **Zyrtar publik** – angazhimi i ndonjë personi fizik apo juridik për të kryer ndonjë aktivitet të caktuar nga Ministria në fushën e mbrojtjes së bimëve.

KREU II MBROJTJA E BIMËVE

Neni 4 Detyrat kryesore

1. Mbrojtja e bimëve përfshinë:

1.1. identifikimin, përcjelljen, parandalimin e hyrjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm në bimë, produkte bimore dhe objekte tjera dhe zhdukjen apo kontrollimin e tyre;

1.2. përcaktimin dhe zbatimin e masave fitosanitare;

1.3. kryerjen e përgjegjësisë dhe detyrave të përcaktuara nga konventat ndërkombëtare, kontratat dhe marrëveshjet për mbrojtjen e bimëve.

Neni 5 Palët dhe detyrat në fushën e mbrojtjes së bimëve

1. Mbrojtja e bimëve është përgjegjësi e Organit Kompetent, e Inspektionit fitosanitar, zyrtarëve publikë të ngarkuar për mbrojtjen e bimëve sipas nenit 52 i këtij ligji dhe prodhuesve bujqësorë.

2. Ministria, Inspektionit fitosanitar, zyrtarët publik të ngarkuar për mbrojtjen e bimëve dhe prodhuesit bujqësorë duhet të bashkëpunojnë vazhdimisht për përcjelljen e gjendjes së shëndetit të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, në mënyrë që të identifikohet e raportohet hyrja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm si dhe për

zhdukjen apo kontrollin e tyre.

3. Ministria, nëpërmjet organeve të veta ekzekutive, mbikëqyr, koordinon dhe propozon Ligje dhe Akte nënligjore për mbrojtjen e bimëve, farërave, bimëve për mbjellje, produkteve për mbrojtjen dhe ushqimin e bimëve.

4. Zyrtarët publik të ngarkuar me mbrojtjen e bimëve duhet të njoftojnë menjëherë inspektorët fitosanitarë dhe organin kompetent për shfaqjet e reja e të papritura të organizmave të dëmshëm të listave I.A. dhe II.A.

5. Çdo person i cili për nga natyra e punës së tij vëren apo dyshon për shfaqje të re e të papritur të organizmave të dëmshëm në bimë, duhet të njoftojë organin kompetent për mbrojtjen e bimëve apo inspektorët fitosanitarë.

6. Për sa i përket mbrojtjes së shëndetit të bimëve pyjore, organi kompetent dhe zyrtarët publik të ngarkuar me mbrojtjen e pyjeve duhet ta ushtrojnë punën e tyre në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore të tij.

Neni 6 Përgjegjësitë e prodhuesve bujqësor

1. Prodhuesi bujqësor është përgjegjës për:

1.1. kontrollin e shëndetit të bimëve gjatë kultivimit të tyre, për të identifikuar e parandaluar përhapjen e organizmave të dëmshëm në zonat ku kultivohen si: ngastra, plantacione, fidanishte, kopshte, pemëtore, serra, bimë natyrore dhe produktet bimore, si edhe objekte të tjera në pronësi të tij apo që dikush tjetër i shfrytëzon në emër të tij;

1.2. njoftimin e inspektionit fitosanitar apo zyrtarëve publik të ngarkuar me mbrojtjen e bimëve për paraqitje të reja e të papritura apo për dyshime mbi praninë e organizmave të dëmshëm në bimë të listave I.A. dhe II.A. ata duhet të njoftojnë menjëherë organin kompetent të Ministrisë;

1.3. marrjen e menjëhershme të masave të përcaktuara nga organi kompetent apo inspeksioni fitosanitar, në mënyrë që të pengohet përhapja dhe të zhduken organizmat e dëmshëm;

1.4. mbajtjen e shënimeve për masat e ndërmarra për mbrojtjen e bimëve dhe lejimin e personave zyrtarë për kontrollimin e tyre;

1.5. lejimin dhe ndihmën gjatë kryerjes së kontrollit inspektues fitosanitar.

2. Nëse prodhuesi bujqësor nuk zbaton masat e përcaktuara në nënparagrafin 1.1. dhe 1.3. të këtij neni, inspektori fitosanitar përcakton zbatimin e tyre në vend të prodhuesit bujqësor.

3. Me përjashtim të dispozitave të nënparagrafit 1.1. dhe 1.3. të këtij neni, prodhuesi bujqësor i cili është pronar apo shfrytëzues i bimëve pyjore, është përgjegjës për të njoftuar menjëherë inspektorët pyjorë dhe zyrtarët publik të ngarkuar me mbrojtjen e pyjeve për shfaqjen e organizmave të dëmshëm të listave I.A. dhe II.A., të cilët menjëherë njoftojnë organin kompetent për mbrojtjen e bimëve në pajtim me paragrafin 4. neni 5 i këtij ligji.

KREU III

PARANDALIMI I HYRJES DHE PËRHAPJES SË ORGANIZMAVE TË DËMSHËM NË BIMË, PRODUKTE BIMORE DHE NË OBJEKTE TË TJERA DHE MASAT PËR LUFTIMIN APO ZHDUKJEN E TYRE

Neni 7 Listat e organizmave të dëmshëm që rregullohen me këtë ligj

1. Organizmat e dëmshëm, sipas rrezikut për shëndetin e disa lloje bimësh dhe sipas natyrës së dëmeve ekonomike në bimët e kultivuara dhe ato pyjore, klasifikohen në listat vijuese:

1.1. Lista I.A.: organizma të dëmshëm, hyrja dhe përhapja e të cilëve ndalohet në territorin e Kosovës dhe prania e të cilave nuk është vërtetuar në ndonjë pjesë të vendit;

1.2. Lista I.A.1.: organizma të dëmshëm, hyrja dhe përhapja e të cilëve ndalohet në territorin e Kosovës edhe nëse është vërtetuar prania e tyre në ndonjë bimë të veçantë apo produkte bimore ose në zona të kufizuara;

1.3. Lista I.B.: organizma të dëmshëm, hyrja dhe përhapja e të cilave ndalohet në zonat e mbrojtura të Kosovës;

1.4. Lista II.A.: organizma të dëmshëm, hyrja dhe përhapja e të cilëve në Kosovë duhet të ndalohet edhe nëse janë të pranishme në disa bimë apo produkte bimore dhe shfaqja e të cilave nuk është e vërtetuar në ndonjë pjesë të vendit;

1.5. Lista II.A.I: organizma të dëmshme, hyrja dhe përhapja e të cilave në Kosovë duhet të ndalohet nëse janë të pranishme në disa bimë apo produkte bimore edhe nëse dihet prania e tyre në vend.

Neni 8

Lista e dërgesave bimore të rregulluara me këtë ligj

1. Bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera të cilët bartin organizma të dëmshëm që rrezikojnë shëndetin e bimëve, hyrja dhe përhapja e të cilave në vend duhet të rregullohet me këtë ligj dhe që klasifikohen si në listat vijuese:

1.1. Lista III.A.: bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera, hyrja e të cilave në Kosovë duhet të ndalohet;

1.2. Lista III.B.: bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera, hyrja e të cilave duhet të ndalohet në zonat e veçanta të mbrojtura;

1.3. Lista IV.A: bimë, produktet bimore dhe objekte të tjera të cilat duhet të plotësojnë kërkesat specifike fitosanitare të vendosura për import dhe qarkullim në Kosovë;

1.4. Lista IV.B.: bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera të cilat, duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta të vendosura për hyrjen dhe qarkullimin në dhe brenda disa zonave të mbrojtura.

1.5. Lista V.A.: bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera të prodhuara në Kosovë, të cilat janë bartës potencialë të organizmave të dëmshëm relevant për vendin dhe që duhet të shoqërohen me një pasaportë bimore për të qarkulluar në gjithë territorin e Kosovës.

1.6. Lista V.A.I: bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera që vijnë nga vende të tjera, të cilat janë bartës potencialë të organizmave të dëmshëm relevant për vendin tonë dhe ato duhet të shoqërohen me certifikatë fitosanitare.

1.7. Lista V.B.: Bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera të cilët janë bartës potencialë të organizmave të dëmshëm relevant për disa zona të mbrojtura dhe të cilat duhet të shoqërohen me një pasaportë bimore të vlefshme për një zonë të caktuar kur futen apo qarkullojnë brenda asaj zone.

2. Listat sipas neneve 7 dhe 8 të këtij ligji duhet të vendosen në anekse të veçanta që janë pjesë përbërëse e këtij ligji, përveç listës I.B në nenin 7 dhe IV.B dhe V.B në nenin 8 të këtij ligji, të cilat ju referohen kërkesave speciale për zonat e mbrojtura, përbërja e të cilave përcaktohet në Akte nënligjore përkatëse.

Neni 9

Kërkesat për raportim për organizmat e dëmshëm karantinorë

1. Kur në Kosovë shfaqen organizma të dëmshëm të përcaktuara sipas listave I.A. I.A. 1 dhe II.A. 1 për gjithë territorin e Kosovës dhe të listës I.B. për zonat e mbrojtura, ose kur në bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera shfaqen simptoma që vendosin dyshime për praninë e të njëjtave organizmave të dëmshëm, prodhuesit bujqësorë dhe zyrtarët publik të ngarkuar me mbrojtjen e bimëve duhet të lajmërojnë menjëherë inspektionin fitosanitar dhe organin kompetent.

2. Prodhuesi bujqësor duhet të mbrojë bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga Inspektorët fitosanitarë.

3. Ministria me akt nënligjor e përcakton mënyrën e lajmërimit.

Neni 10

Laboratori referent fitosanitar

1. Kur dyshohet për praninë e organizmave të dëmshëm, inspektori fitosanitar mund të marrë dhe dërgojë disa mostra

reprezentative për analiza të mëtejshme në laboratorin fitosanitar për diagnostikimin e parazitëve në Institutin Bujqësor të Kosovës, Universitetet përkatëse si dhe laboratorë tjerë të akredituar.

2. Laboratori fitosanitar për diagnostikim të parazitëve në Institutin Bujqësor të Kosovës, Universitetet përkatëse si dhe laboratorë tjerë të akredituara:

2.1. përdor metodat e duhura për trajtimin dhe ruajtjen e mostrave të organizmave të dëmshëm duke parandaluar rrezikun e përhapjes së tyre, provon praninë e tyre, mbanë evidencën e mostrave dhe paraqet rregullisht shënime mbi analizat;

2.2. nëse konstatohen organizma të dëmshëm të përfshira në listat I.A., I.A.1, II.A., II.A.1 apo në listën I.B, .B. dhe II.B. njofton menjëherë organin kompetent, i cili nga ana e tij informon prodhuesit bujqësorë dhe subjekte të tjera për shfaqjen e organizmave të dëmshëm dhe rrezikun e tyre dhe i këshillon për veprimet dhe masat paraprake që duhet të merren.

Neni 11

Mbajtja e Shënimeve për organizmat e dëmshëm

1. Organi kompetent mban evidencë në mënyrë të rregullt dhe i ruan të gjitha shënime lidhur me shfaqjen e organizmave të dëmshëm në vend për të pasur e siguruar të dhëna të sakta me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.

2. Ministria, me akt nënligjorë e përcakton përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së shënimeve për :

2.1. identifikimin e organizmave të rinj të dëmshëm të listave I.A. dhe II.A. në Kosovë, të cilat mund të shpallën rregullisht,

2.2. shpalljen e të dhënave për identifikimin e ri të organizmave të dëmshëm të listave I.A. dhe II.A.

Neni 12

Zonat e rregulluara me këtë ligj

1. Nëse vërtetohet prania e organizmave të dëmshëm dhe ka rrezik për përhapjen e tyre në zonën e rregulluar me këtë ligj, inspektori fitosanitar :

1.1. jep të dhëna për vendndodhjen e tyre dhe urdhëron marrjen e masave fitosanitare të përcaktuara nga organi kompetent;

1.2. në varësi të llojit të organizmave të dëmshëm njofton rregullisht prodhuesit bujqësorë për vendin e shfaqjes së tyre.

2. Ministria, me akt nënligjor përcakton kufijtë e territorit nën mbikëqyrje, masat që duhet të merren për identifikimin dhe parandalimin e përhapjes së organizmave të dëmshëm, dhe masat që merren në pajtim me nenin 44 të këtij ligji.

Neni 13

Zonat e mbrojtura

1. "Zonë e mbrojtur" është një zonë e vendit e njohur zyrtarisht nga Organi Kompetent, në të cilin:

1.1. një apo më shumë organizma të dëmshëm që përmenden në këtë ligj, të cilët gjenden në një apo më shumë zona të vendit apo të vendeve fqinje, nuk janë endemike apo të pranishme, pavarësisht nga kushtet e favorshme për të qenë të pranishme.

1.2. ka rrezik që disa organizma të dëmshëm, në saje të kushteve ekologjike të përshtatshme, të vendosen në kultura të caktuara pavarësisht faktit se këta organizma nuk janë endemike apo të pranishme në vend.

2. Një organizëm i dëmshëm do të konsiderohet i vendosur në një zonë për këtë arsye ajo e humb statusin e zonës së mbrojtur nëse konstatohet prania e tij dhe nëse atje nuk janë marrë masa zyrtarisht për zhdukjen e tij ose këto masa janë treguar të pa-efektshme për një periudhë të paktën dyvjeçare.

3. Në zonat e shpallura zona të mbrojtura, inspektorët fitosanitarë duhet të kryejnë mbikëqyrje zyrtare sistematike dhe të rregullta për praninë e organizmave të dëmshëm lidhur me të cilët është njohur si zonë e mbrojtur.

4. Ministria me akt nënligjor e përcakton shpalljen e zonave të mbrojtura, listat e organizmave të dëmshëm të përfshira, kushtet për mbikëqyrjen sistematike të tyre dhe qarkullimin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, brenda zonës së mbrojtur.

KREU IV

NDALESAT DHE KUFIZIMET PËR HYRJEN DHE PËRHAPJEN E ORGANIZMAVE TË DËMSHËM NË BIMË

Neni 14

Ndalimi i hyrjes së organizmave të dëmshëm

1. Ndalohet hyrja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm të përfshira në listat I.A., I.A.1, II.A. dhe II.A.1 në gjithë territorin e Kosovës.
2. Ndalohet hyrja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm të përfshira në listën I.B. në zonat e mbrojtura.
3. Hyrja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm të cilët nuk përfshihen në listat sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, gjithashtu janë të ndaluara nëse rrezikojnë shëndetin e bimëve në territorin e Kosovës.

Neni 15

Ndalesat e mallrave të importit

1. Në territorin e Kosovës ndalohet importi i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përcaktuara në listën III.A.
2. Në zonat e mbrojtura ndalohet importi i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përfshira në listën III.B.
3. Ndalohet importi dhe qarkullimi i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përfshira në listën IV.A, nëse nuk janë zbatuar masat e përcaktuara fitosanitare.
4. Ndalohet importi dhe qarkullimi i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përfshira në listën IV.B., në territoret e shpallura zona të mbrojtura, nëse nuk janë zbatuar masat e përcaktuara fitosanitare.
5. Ministria me akt nënligjor e përcakton importin dhe qarkullimin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përfshira në listat sipas paragrafëve 1., 2., 3. dhe 4. të këtij neni, nëse ato përbëjnë rrezik për shëndetin e bimëve në territorin e Kosovës.

Neni 16

Hyrja dhe bartja e materialit për hulumtim shkencor apo për qëllim të seleksionimit klonal

1. Me përjashtim të dispozitave të nenit 14 dhe 15 të këtij ligji, personat juridikë që merren me veprimtari shkencore-hulumtuese, mund të importojnë ose qarkullojnë organizma të dëmshëm të përfshira në listat I.A., I.A.1, IIA, II.A.1, I.B. dhe bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera të paraqitura në lista III.A., III.B., IV.A. dhe IV.B., në qoftë se:

- 1.1. janë të pajisur me leje për import;
- 1.2. i përdorin ato për ekzaminime, hulumtime ose për punë seleksionuese të bimëve;
- 1.3. plotësojnë kushtet e parapara profesionale, shkencore dhe teknike, të përcaktuara nga organi kompetent.

2. Lejet sipas paragrafit 1. të këtij neni, lëshohen nga organi kompetent i Ministrisë në bazë të kërkesës së bërë nga personi juridik shkencor.

3. Kërkesa, duhet të përmbajë:

- 3.1. të dhëna për paraqitësin e kërkesës;
- 3.2. të dhëna mbi organizmat e dëmshëm të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera sipas paragrafit 1 të këtij neni.

- 3.3. vendin e origjinës dhe prejardhjen e materialit;
- 3.4. objektivat e eksperimentit shkencor ose të punës seleksionuese klonale dhe kohëzgjatjen;
- 3.5. vendin ku kryhet eksperimenti me përshkrimin e pajisjeve e mjeteve karantinore;
- 3.6. metodën që përdoret për asgjësimin apo trajtimin e materialit pas përfundimit të eksperimentit.

4. Organi kompetent mban evidencë për importin e bimëve sipas nënparagrafit 3.2. të paragrafit 3. të këtij neni.

5. Në momentin e hyrjes së materialit inspektori fitosanitar verifikon nëse ai është në përputhje me materialin e kërkuar dhe nëse janë të gjitha dokumentet e nevojshëm si: certifikata e origjinës dhe leja e importit e lëshuar nga organi kompetent.

6. Bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera të cilat gjatë masave të përmendura rezultojnë të infektuara nga organizmat e dëmshëm të treguar në paragrafin 1. të këtij neni dhe gjithë bimët, produktet bimore dhe objekte të tjera me të cilat kanë qenë në kontakt ose mund të jenë kontaminuar, duhet të asgjësohen ose të trajtohen në pajtim me rekomandimet e paraqitura nga inspektori fitosanitar.

7. Për ndonjë material, përfshirë organizmat e dëmshme dhe mbase ndonjë material tjetër i cili mund të jetë kontaminuar gjatë provave, kur përfundojnë aktivitetet e miratuara, inspektori fitosanitar duhet të sigurojë që:

7.1. materiali, si dhe organizmat e dëmshëm dhe materialet që mund të jenë kontaminuar dhe gjithë bimët, produktet bimore ose produkte të tjera me të cilat kanë qenë në kontakt ose mund të jenë kontaminuar, duhet të asgjësohen, sterilizohen apo t'u nënshtrohen trajtimeve të duhura;

7.2. mjediset dhe mjetet ku janë kryer veprimtaritë, duhet të sterilizohen ose të pastrohen.

8. Ministria me akt nënligjor e përcakton kërkesat për aftësi profesionale dhe teknike, përmbajtjen dhe formularin e lejes për importin e bimëve dhe produkteve të tjera.

Neni 17

Përrjashtimet në importin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera

1. Me përrjashtim të dispozitave të neneve 14 dhe 15 të këtij ligji, organi kompetent në pajtim me kërkesat e përcaktuara dhe nëse vlerëson se nuk ka rrezik për përhapjen e organizmave të dëmshëm, në raste të veçanta mund të lejojë importin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të cilat kultivohen ose përdorën për nevoja personale dhe destinohen për mbjellje ose për përdorim personal të menjëhershëm.

2. Organi kompetent mban shënime për importin e lejuar sipas paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 18

Dispozita të veçanta për hyrjen ose qarkullimin e dërgesave bimore

1. Dispozitat e neneve 14 dhe 15 të këtij ligji nuk janë të zbatueshme nëse:

1.1. dërgesa bimore është në transit në Kosovë;

1.2. sasi të vogla të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, përrfshirë artikuj ushqimorë dhe ushqim për kafshë, të destinuara për përdorim personal, industrial ose jo komerciale ose për ushqimin e kafshëve gjatë transportit.

2. Sasi të vogla sipas nënparagrafit 1.2 paragrafit 1. të këtij neni duhet të zbatohen për: fruta të freskëta dhe perime, përveç patateve, lule të prera dhe buqeta, farëra në paketim origjinal, përveç farës së patates, rizoma të bimëve dekorative, pjesëve të prera të drurëve halorë - pa rrënjë për festime të ndryshme dhe lule në saksi të destinuara vetëm për nevojat e përdoruesve të fundit.

3. Ministra me akt nënligjor përcakton sasi të vogla të bimëve sipas këtij neni.

KREU V

REGJISTRI I PRODHUESVE, PAKETUESVE, PËRPUNUESVE, IMPORTUESVE, SHPËRNDARËSVE DHE DEPONUESVE TË BIMËVE

Neni 19 Kërkesat për regjistrim

1. Personat juridik dhe fizik mund të kryejnë prodhimin, paketimin, përpunimin, importin, deponimi dhe shpërndarjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera sipas listave V.A., V.A.1. dhe V.B., nëse ata i përmbushin kërkesat e parapara për këto veprimtari dhe janë të regjistruar zyrtarisht në Regjistrin e Ministrisë.
2. Regjistrimi është i detyrueshëm për:
 - 2.1. prodhues të fidanëve, përpunues, paketues, shpërndarës, deponues të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera sipas listave V.A. dhe V.A.1;
 - 2.2. importuesit e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera sipas listës V.B.
3. Organi kompetent lëshon licencën që vërteton regjistrimin mbas kryerjes së një verifikimi inspektues nga inspektorët fitosanitarë.
4. Ministria me akt nënligjor e përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrave.

Neni 20 Procedura për regjistrim

1. Për t'u regjistruar sipas nenit 19 të këtij ligji, personat me aftësitë e duhura profesionale për prodhimin dhe mbrojtjen e bimëve duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara sipas nenit 21 të këtij ligji.
2. Për regjistrim sipas nenit 21 të këtij ligji, duhet t'i dërgohet një kërkesë me shkrim organit kompetent
3. Ministria merr një vendimin për regjistrimin jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga marrja e kërkesës dhe dokumentacionit.
4. Nëse ndonjë subjekt i regjistruar nuk përmbush detyrimet dhe kërkesat sipas këtij ligji, Ministria anulon regjistrimin e tij.

Neni 21 Detyrat e personave të regjistruar

1. Personat e regjistruar janë të detyruar të:
 - 1.1. mbajnë shënime për prodhimin, paketimin, përpunimin dhe qarkullimin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të cilat i kanë në ruajtje apo planifikojnë t'i rimbjellin në pronën e tyre, t'i përpunojnë ose shpërndajnë në një vend tjetër;
 - 1.2. mbajnë dhe plotësojnë rregullisht planin e vendosjes aty ku bimët kultivohen, përpunohen, ruhen dhe përdoren;
 - 1.3. kryejnë në mënyrë të rregullt kontrolle vizuale në bimë;
 - 1.4. lejojnë qasjen e inspektorëve fitosanitarë për të inspektuar dhe kontrolluar bimët, vendosjen e tyre dhe dokumentacionin, si dhe për të marrë mostra;
 - 1.5. lajmërojnë organin kompetent në Ministri ose Inspektionin fitosanitar për të gjitha paraqitjet dhe shtimin e numrit të organizmave të dëmshëm në bimë dhe për prodhimtarinë e tyre;
 - 1.6. paraqesin organit kompetent të gjitha ndryshimet e të dhënave të cilat mbahen në regjistër në afatin e përcaktuar nga Ministria;

1.7. raportojnë brenda afatit të duhur çdo vit organin kompetent dhe Inspektionin fitosanitar për sasinë dhe vendndodhjen e prodhimit dhe përpunimit të bimëve dhe të produkteve bimore;

1.8. bashkëpunojnë me organin kompetent dhe me Inspektionin fitosanitar në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit të bimëve; dhe

1.9. të ruajnë dokumentacionin së paku një (1) vit.

2. Ministria me akt nënligjor i përcakton teknikat e kryerjes së kontrollit shëndetësor të bimëve, afatet, përmbajtjen dhe mënyrën e dërgimit të të dhënave të përcaktuara sipas nënparagrafit 1.1., paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 22 **Përgjashtime nga regjistrimi**

Përgjashtuar nga dispozitat e nenit 21, regjistrimi nuk është i detyrueshëm për prodhuesit dhe përpunuesit e vegjël të cilët nuk kryejnë prodhim dhe përpunim profesional të bimëve, ose kur prodhimi dhe shitja e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të tyre destinohet për nevoja personale të personave fizik në tregun lokal që nuk rrezikon përhapjen e organizmave të dëmshëm.

KREU VI

IMPORTI, EKSPORTI DHE TRANZITI I DËRGESAVE BIMORE

Neni 23 **Importi**

1. Importi i bimëve lejohet nëse:

1.1. importuesi është i pajisur me licencë importi të lëshuar nga organi kompetent i Ministrisë,

1.2. dërgesa e bimëve importohet nëpërmjet pikave hyrëse në të cilat ekziston inspektioni fitosanitar.

2. Pikat e hyrjes duhet të përmbushin kushtet e përcaktuara për kryerjen e kontrollit shëndetësor të dërgesave bimore.

Neni 24 **Kërkesat për importin e dërgesave bimore**

1. Dërgesat bimore të përfshira në listën V.A.I., ambalazhi dhe mjetet me të cilat transportohet duhet t'i nënshtrohen kontrollit të detyrueshëm të inspektimit fitosanitar në pikën e hyrjes, i cili vërteton se:

1.1. dërgesa bimore shoqërohet me certifikatë fitosanitare;

1.2. në dërgesën bimore nuk ka prani të organizmave të dëmshëm të listave I.A. dhe I.A.1.;

1.3. në dërgesën bimore nuk ka prani të organizmave të dëmshëm të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera nga listave II.A. dhe II.A.1.;

1.4. dërgesa bimore plotëson kërkesat e veçanta fitosanitare në deklaratën shtesë në pajtim me listën IV.A.

2. Çdo dërgesë sipas nënparagrafi 1.1. paragrafit 1., të këtij neni, duhet të shoqërohet me certifikatë fitosanitare të vendit të origjinës, ose me certifikatë fitosanitare për riekспортim të lëshuar nga vendi i prejardhjes nëse ai nuk korrespondon me vendin e origjinës, kur dërgesa bimore duhet të përmbushë kërkesat e listave IV.A. dhe IV.B.

3. Kur një dërgesë sipas paragrafit 1. të këtij neni e shoqëruar me certifikatë fitosanitare të vendit të vet të origjinës, transportohet, deponohet, ripaketohet ose ndahet në një vend tjetër i cili nuk është vend i origjinës, duhet ta ketë certifikatën ose kopjen e saj të notuar të shoqëruar me certifikatë fitosanitare për riekспорт të lëshuar nga vendi tjetër.

4. Kur një dërgesë sipas paragrafit 1. i këtij neni, importohet në vazhdimësi në më shumë se një vend dhe ka me vete më shumë se një certifikatë fitosanitare për riekспорт, ajo duhet të shoqërohet me certifikatën fitosanitare origjinale

ose kopjen e saj të noteruar dhe certifikatat fitosanitare origjinale ose kopjet e tyre të lëshuara nga të gjitha këto vende.

5. Çfarëdo dërgesë tjetër e materialit bimorë, materialit prej druri i cili përdoret në paketimin apo transportimin e materialit bimorë, ambalazhit apo mjeteve me të cilat transportohet materiali bimorë duhet ti nënshtrohet kontrolleve inspektuese në pikën e hyrjes nëse inspektori fitosanitar dyshon se ka rrezik për përhapjen e organizmave të dëmshëm në bimë.

6. Ministria me akt nënligjor e përcakton procedurat e kontrollit inspektues sipas nënparagrafit 1.2. dhe 1.3. të paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 25

Kërkesat për import të dërgesave bimore për import në zonat e mbrojtura

1. Çfarëdo dërgesë e përfshirë në listën V.B. e importuar në zonat e mbrojtura, përveç kërkesave të përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji, duhet të përmbushë edhe kërkesat e mëtejshme si vijon:

- 1.1. të mos ketë të pranishëm organizma të dëmshëm sipas listës I.B.;
- 1.2. të mos përmbajë bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera sipas listës III.B. dhe;
- 1.3. të përmbushë kërkesat e veçanta fitosanitare sipas listës IV.B.

Neni 26

Procedurat për importin e dërgesave bimore

1. Importuesit, transportuesit ose përfaqësuesit e tyre dhe personat fizik të cilët i importojnë në Kosovë bimë sipas paragrafit 1. të nenit 24 të këtij ligji, janë të detyruar:

- 1.1. të njoftojnë rregullisht inspektionin fitosanitar për arritjen e dërgesave të importuara ose ripaketuara gjatë transportit, në mënyrë që t'i nënshtrohen kontrollit fitosanitar;
- 1.2. t'u kërkojnë inspektorëve fitosanitarë që të ndërmarrin gjithë masat e përcaktuara lidhur me dërgesat bimore që do të importohen.

2. Dërgesat bimore sipas nenit 24 të këtij ligji, kontrollohen në pikat e hyrjes të Kosovës, ku kryhen edhe procedurat e tjera administrative doganore. Dërgesa nuk mund të largohet nga pika e hyrjes nëse nuk janë kompletuar të gjitha vlerësimet e nevojshme fitosanitare.

3. Në raste të veçanta dhe të kërkesave të përcaktuara nga Ministria, nëse nuk ka rrezik për përhapjen e organizmave të dëmshëm, kontrolli fitosanitar i dërgesave bimore, mund të kryhet në vende të përcaktuara posaçërisht brenda territorit të Kosovës por nën mbikëqyrjen e inspektorëve fitosanitarë.

4. Organet e kontrollit doganor nuk mund të fillojnë procedurat doganore para se inspektori fitosanitar të ketë kontrolluar çfarëdo dërgesë bimore sipas nënparagrafi 1.1. të paragrafit 1. të këtij neni dhe të ketë dhënë lejen e importimit, përveç dërgesave në kalim transit.

Neni 27

Procedurat përjashtuese për importin e dërgesave bimore

1. Përjashtuar nga paragrafi 1. neni 17 i këtij ligji, leja e importimit duhet të lëshohet për bimët e pranishme në listën V.A.1. pa ndonjë certifikatë fitosanitare apo kontroll inspektues fitosanitar kur ato destinohen për përdorim personal ose për përdorim të menjëhershëm brenda zonës kufitare të vendit nga importohen bimët, produktet bimore dhe objektet tjera.

2. Sasi të vogla të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të paraqitura në listën V.B., në pajtim me nenin 18 të këtij ligji mund të importohen pa certifikatë fitosanitare apo kontroll inspektues fitosanitar.

Neni 28

Inspektimi në pikën e hyrjes

1. Nëse pas kontrollit janë përmbushur gjithë kërkesat sipas neneve 24 dhe 25 të këtij ligji, Inspektori fitosanitar

verifikon certifikatën fitosanitare origjinale dhe certifikatat e mundshme të rieksporit duke vulosur dhe shënuar datën e hyrjes dhe lëshon certifikatën fitosanitare për importim.

2. Nëse kërkesat paraprake nga neni 27 dhe 28 i këtij ligji, nuk janë përmbushur, inspektori fitosanitar me vendim e ndalon importin dhe përcakton masat në pajtim me dispozitat sipas paragrafit 1. të nenit 12 të këtij ligji dhe vulos certifikatën fitosanitare ose certifikatën e rieksporit me një vulë trekëndëshe të kuqe, për bërjen e tyre të pavlefshme.

3. Nëse gjatë kontrollit inspektues vërtetohet se një pjesë e dërgesës bimore është e infektuar me organizma të dëmshëm nga lista I.A., I.A.1, II.A., II.A.1 ose II.B., importi i tyre ndalohet.

4. Inspektori fitosanitar mund të kryejë një kontroll tjetër inspektues nëse ai dyshon se dërgesa e importuar, në kundërshtim me atë që raportohet në dokumentet shoqëruese, përmban bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera nga lista V.B., ose nëse ka rrezik për përhapjen e organizmave të dëmshëm.

5. Nëse pas kontrollit inspektues, inspektori fitosanitar ka ende dyshim për identitetin e dërgesës bimore, posaçërisht për llojin, tipin dhe origjinën e bimëve nga lista V.A.1 dhe për praninë e organizmave të dëmshëm sipas listave I.A dhe II.A, ai mund të përsërisë kontrollin inspektues, duke u këshilluar me ekspertë të tjerë ose duke i dërguar një mostër reprezentative në laboratorin fitosanitar për diagnostikimit të parazitëve në Institutin Bujqësor të Kosovës, Universitetet përkatëse si dhe laboratorë tjerë të akredituar.

6. Ministria me akt nënligjor e përcakton formën, madhësinë dhe përmbajtjen e vulës sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni.

Neni 29 Eksporti

1. Eksporti i bimëve lejohet nëse:

1.1. dërgesat bimore janë me origjinë nga Kosova. Para lëshimit të certifikatave fitosanitare, inspektori fitosanitar kryen kontrolle inspektuese, për të siguruar se janë përmbushur të gjitha kërkesat fitosanitare të vendit ku do të eksportohen dërgesat;

1.2. dërgesat bimore që eksportohen nuk janë me origjinë nga Kosova, por janë deponuar, ripaketuar dhe ndarë në Kosovë. Para lëshimit të certifikatave për riekспорт, inspektori fitosanitar kryen kontrolle fitosanitare për të siguruar se janë përmbushur të gjitha kërkesat fitosanitare të vendit ku do të eksportohen dërgesat.

2. Certifikata për riekспорт konsiderohet dokument zyrtar, kur inspektori fitosanitar, vërteton përmbushjen e kërkesave sipas nënparagrafit 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni.

3. Ministria me akt nënligjor e përcakton formatin dhe përmbajtjen e certifikatave fitosanitare.

Neni 30 Detyrat e eksportuesit

1. Kërkesa për lëshimin e certifikatës fitosanitare dërgohet nga eksportuesi inspektoratit fitosanitar i cili është përgjegjës të kryejë kontrollin inspektues dhe të marrë një vendim në bazë të kërkesës së eksportuesit brenda afateve të përcaktuara nga Ministria.

2. Eksportuesi, me shpenzimet e veta, duhet të zbatojë të gjitha masat e përcaktuara nga inspektori fitosanitar pas inspektimit të dërgesës bimore që do të eksportohet.

Neni 31 Dërgesa në kalim transit

1. Për dërgesën në kalim transit kontrolli inspektues nuk është i detyrueshëm sipas nënparagrafëve 1.1., 1.2., 1.3. dhe 1.4. të paragrafit 1 të nenit 24 të këtij ligji nëse ajo është e paketuar në mënyrë që nuk rrezikon përhapjen e organizmave të dëmshëm dhe nuk deponohet, ndahet, ripaketohet ose kombinohet me dërgesa të tjera në territorin doganor të Kosovës.

2. Nuk lejohet kalim transit i dërgesave të cilat nuk janë në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

KREU VII TRANSFERIMI I DËRGESËS SË BIMËVE

Neni 32 Pasaporta Bimore

1. Pasaporta bimore është dokument zyrtar që lëshohet nga organi kompetent për çfarëdo dërgese të bimëve të përfshira në Listën V.A.
2. Bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera në Listat V.A. dhe V.B., me përjashtim të atyre që prodhohen nga prodhuesit dhe përpunuesit e vegjël të përcaktuar në nenin 25 paragrafi 1 ose ato në pajtim me nenin 27 të këtij ligji, mund të qarkullojnë në Kosovë vetëm nëse janë të shoqëruara me pasaportë bimore.
3. Sasi të vogla të bimëve, produkteve bimore, ushqimeve ose ushqimeve për kafshë, të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni për qëllim përdorimi personal, për përdorim jo industrial, bujqësor apo tregtar ose për konsum gjatë transportit, mund të qarkullojnë në vend edhe kur nuk shoqërohen me pasaportë bimore, me kusht që të mos përbëjnë rrezik për përhapjen e organizmave të dëmshëm.
4. Me përjashtim të dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera të destinuara për eksport, mund të qarkullojnë brenda territorit të Kosovës nëse ato shoqërohen me certifikata fitosanitare.

Neni 33 Autorizimi për përdorim të Pasaportës bimore

1. Subjektet e regjistruar sipas paragrafi 2. të nenit 19 të këtij ligji, të cilët duan të përdorin pasaportë bimore, duhet t'i bëjnë kërkesë për autorizim të veçantë organit kompetent.
2. Ministria lëshon këtë autorizim të veçantë pasi të ketë marrë raportin miratues nga inspekcioni fitosanitar.
3. Organi kompetent përcakton procedurat për lëshimin e pasaportës që përcaktohen në paragrafin 1. të këtij neni, në pajtim me paragrafin 2. të nenit 21 të këtij ligji.

Neni 34 Llojet e pasaportave bimore

1. Pasaporta bimore përbëhet nga një etiketë apo dokument zyrtar dhe mund të jetë e tipave të ndryshme si në vijim :
 - 1.1. pasaportë e zakonshme;
 - 1.2. pasaportë e ndryshuar - RP ose PN;
 - 1.3. Pasaportë për Zonat e mbrojtura - ZP ose PZM.
2. Etiketat zyrtare shtypen nga organi kompetent dhe mbahen nga personat që i përdorin, nën kontrollin e inspektorëve fitosanitarë.
3. Pasaportat bimore duhet të plotësohen në tërësi me shkronja të shtypit dhe me ngjyrë që nuk shlyhet, me emër latin dhe botanik të bimëve apo produkteve bimore, pasaporta është e pavlefshme nëse ka pjesë të fshira apo korrigjime të pavërtetuara.
4. Në vend të etiketave të pasaportës sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, lejohet përdorimi i pasaportës së thjeshtuar, kur të dhënat që jep pasaporta e që tregojnë llojet e veçanta, jepen në një kornizë të veçantë në dokumentin që shoqëron mallin -faturë, lidhëse e paketimit.
5. Ministria me akt nënligjor e përcakton përmbajtjen e pasaportave bimore.

Neni 35 Përdorimi i Pasaportës bimore

1. Palët e interesuara, nën përgjegjësinë e tyre, duhet t'i vendosin pasaportat bimore mbi bimë, produkte bimore, objekte të tjera apo paketimet e tyre, në mënyrë që ato të mos të përdoren përsëri.

2. Tregtarët me pakicë dhe shpërndarësit e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera si dhe përdoruesit e fundit të cilët merren me prodhimin e bimëve, e ruajnë pasaportën bimore për të paktën një (1) vit.
3. Nëse një pasaportë përdoret për një bimë, produkt bimor ose objekte të tjera të importuara nga vende të tjera, ai duhet të tregojë edhe vendin e origjinës.
4. Kur dërgesat bimore hyjnë në territorin e Kosovës, certifikata fitosanitare mund të zëvendësojë pasaportën bimore deri në vendin e parë të destinimit në Kosovë.
5. Subjektet e autorizuara për të përdorur pasaportë, përveç kërkesave të tjera sipas paragrafit 1. të nenit 21 të këtij ligji, duhet të përmbushin kërkesat e veçanta si vijon:
 - 5.1. të paraqesin të gjitha ndryshimet e kërkesave për lëshimin e pasaportave bimore organit kompetent brenda afatit të caktuar;
 - 5.2. të bëjnë kujdes që pasaporta bimore të jetë e plotësuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji;
 - 5.3. të njoftojnë inspektorin fitosanitar brenda afatit të përcaktuar për transferimin e dërgesës bimore në zonat e mbrojtura;
 - 5.4. të lejojnë inspektorin fitosanitar të jetë i pranishëm dhe të ketë qasje ndaj dokumentacionit dhe dërgesave në të gjitha fazat e prodhimit dhe përpunimit si dhe në pronën e tyre.
6. Ministria me akt nënligjor e përcakton afatet e paraqitjes dhe ruajtjes së dokumenteve.

Neni 36 Zëvendësimi i Pasaportës -PN

1. Pas lëshimit të saj, pasaporta bimore mund të zëvendësohet me një "pasaportë të ndryshuar", e cila duhet gjithnjë të tregojë kodin e prodhuesit origjinal, në pajtim me dispozitat në vijim:
 - 1.1. në rast të ndarjes apo ndryshimit të statusit fitosanitar të dërgesave, për të cilat zbatohen kërkesat e përcaktuara në listën IV.A;
 - 1.2. me kërkesën e palës së interesuar e cila zyrtarisht është e regjistruar.
2. Nëse dërgesat bimore ndahen ose përbëhen nga pjesë të ndara, duhet të lëshohen pasaporta të ndryshuara për secilën pjesë të dërgesës.
3. Nëse gjendja e dërgesës bimore ndryshon sipas këtij neni, ndryshimi i pasaportës bimore mund të lëshohet vetëm pas përsëritjes së kontrollit inspektues. Kjo zbatohet për dërgesat bimore që importohen te lista V.A.1, të cilat shoqërohen me certifikata fitosanitare. Pas kryerjes së kontrollit fitosanitar, inspektori fitosanitar i propozon organit kompetent lëshimin e pasaportave bimore të ndryshuara, të cilat zëvendësojnë certifikatat fitosanitare.
4. Në rast të përdorimit të pasaportës së ndryshuar, kodit të prodhuesit apo importuesit të shënuar në pasaportën origjinale duhet t'i shtohet shenja "RP".
5. Pasaporta e ndryshuar mund të lëshohet pas një njoftimi drejtuar organit kompetent dhe pas ndonjë inspektimi të mundshëm. Leja për të përdorur pasaportat e ndryshuara mund t'u jepet vetëm aplikuesve të cilët ofrojnë siguri për identitetin e produkteve dhe për mungesën e rreziqeve për shëndetin e bimëve.

Neni 37 Pasaporta për Zonën e Mbrojtur - ZP ose PZM

1. Çfarëdo dërgesë bimore sipas listës V.B. mund të futet në zonat e mbrojtura, të qarkullojë brenda këtyre zonave vetëm kur shoqërohet me pasaporta bimore të vlefshme për zonat e mbrojtura, vetëm kur zbatohen të gjitha kërkesat për qarkullim.
2. Ministria me akt nënligjor i përcakton kërkesat për qarkullim sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 38 **Inspektimet për lëshimin e Pasaportës bimore**

1. Çfarëdo dërgesë e bimëve të përfshira në listën V.A.1, të kultivuara apo përdorura nga persona regjistrimi i të cilëve është i detyrueshëm dhe të destinuara për të qarkulluar, duhet t'i nënshtrohen inspektimit fitosanitar për të siguruar se:

1.1. nuk janë të infektuara me organizma të dëmshëm të listave I.A. dhe II.A., dhe

1.2. i përmbushin kërkesat e veçanta fitosanitare të listës IV.A.

2. Çfarëdo dërgesë e bimëve të përfshira në listën V.B, të destinuara për qarkullim brenda zonave të mbrojtura, përveç kontrolleve inspektuese sipas nënparagrafi 1.1. paragrafit 1. të këtij neni, duhet t'i nënshtrohen kontrolleve inspektuese fitosanitare për të siguruar se:

2.1. nuk janë të infektuara me organizma të dëmshëm të listave I.B. dhe II.B. ;

2.2. i përmbushin kërkesat e veçanta fitosanitare të përcaktuara në listën IV.B.

3. Kontrollat inspektuese të cilat vërtetojnë përmbushjen e kërkesave sipas nënparagrafit 1.1. dhe 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni, kryhen në pajtim me metodat e përcaktuara me këtë ligj.

4. Përveç kontrolleve inspektuese të cilat vërtetojnë përmbushjen e kërkesave sipas nënparagrafit 1.1. dhe 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni, në mjediset e blerësit mund të kryhen kontrole të tjera të rastësishme, për të vërtetuar gjendjen shëndetësore të bimëve, pavarësisht nga origjina e bimëve, vendi ku bimët janë transferuar, kultivuar, përpunuar, ruajtur, shitur apo përdorur në ndonjë mënyrë tjetër.

5. Nëse gjatë kontrolleve inspektuese, inspektori fitosanitar dyshon për rrezik të përhapjes së organizmave të dëmshëm, ose nuk plotësohen kërkesat e parapara për qarkullimin e dërgesave, inspektori fitosanitar urdhëron marrjen e masave të parapara sipas nenit 44 të këtij ligji. Në rast dyshimi për praninë e organizmave të dëmshëm, inspektori fitosanitar mund të mbledhë dhe dërgojë disa mostra tek laboratorët fitosanitar për diagnostifikimin e parazitëve në Institutin Bujqësor të Kosovës, Universitetet përkatëse si dhe laboratorë tjerë të akredituar referentë për kontroll në pajtim me paragrafin 1. të nenit 12 të këtij ligji.

6. Nëse gjatë kontrollit inspektues fitosanitar, konstatohet se një pjesë e dërgesës është e infektuar me organizma të dëmshme të pranishme në listat I.A., II.A., I.B. ose II.B., nuk duhet të lëshohet pasaporta bimore. Ajo mund të lëshohet vetëm për pjesën e cila nuk dyshohet të jetë e infektuar me organizma të dëmshëm dhe nuk paraqet ndonjë rrezik për përhapjen e organizmave të dëmshëm me kusht që kjo pjesë të jetë qartë e dallueshme dhe e veçuar nga ajo e infektuar si pjesë, kultivarë apo lloje të ndryshme.

KREU VIII **KONTROLLET FITOSANITARE PËR PRODHIM DHE QARKULLIM**

Neni 39 **Mbikëqyrja e kontrollit fitosanitar**

1. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji bëhet nga organi kompetent përmes inspektionit fitosanitar.

2. Në lëmin e pylltarisë, mbikëqyrja dhe zbatimi bëhet nga organi kompetent, përmes inspektionit fitosanitar dhe organeve përkatëse të pylltarisë.

Neni 40 **Inspektimet dhe kontrollet fitosanitare**

1. Inspektimet, kontrollet dhe masat zyrtare të cilat sigurojnë pajtueshmëri ndaj dispozitave të këtij ligji do të ekzekutohen nga inspektorët fitosanitarë, të cilët për disa raste të veçanta mund të kërkojnë këshilla dhe mbështetje në laboratorin fitosanitar për diagnostikim të parazitëve në Institutin Bujqësor të Kosovës, Universitetet përkatëse si dhe laboratorë tjerë të akredituar.

2. Bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera në listën V.A., përfshirë paketimin dhe mjetet e transportit, nëse është e nevojshme, që të qarkullojnë duhet të inspektohen zyrtarisht nga inspektorët fitosanitarë, tërësisht ose me mostra

për të siguruar se:

2.1. bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera nuk janë të infektuara nga organizmat e dëmshëm të përfshira në listën I.A.;

2.2. bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera të përfshira në listën II.A nuk janë të infektuara nga organizmat e dëmshëm që përshkruhen në të njëjtën listë.

2.3. bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera sipas listës IV.A. janë në pajtim me kërkesat e veçanta që përcaktohen në të njëjtën listë.

3. Inspektimet ndaj personave juridik dhe fizik të regjistruar zyrtarisht në përputhje me nenin 22 të këtij ligji kryhen rregullisht. Kontrollat në drejtim të caktuar do të kryhen atëherë kur ka dyshime të bazuara se një apo më shumë dispozita të këtij ligji nuk përmbushen.

4. Në bazë të përgjegjësisë të përcaktuara nga ky ligj, inspektori fitosanitar është i autorizuar të:

4.1. kryejë kontrolle inspektuese të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera nën mbikëqyrje;

4.2. verifikojë regjistrin e prodhuesve, paketuesve, përpunuesve, importuesve dhe shpërndarësve të llojeve të veçanta bimore;

4.3. verifikojë plotësimin e kërkesave nga personat e autorizuar për lëshimin e pasaportave bimore dhe personave të tjerë të autorizuar në pajtim me këtë ligj;

4.4. mbikëqyrë ruajtjen e gjendjes shëndetësore për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera sipas autorizimeve të dhëna;

4.5. lëshojë certifikata fitosanitare për import, eksport dhe riekport në bazë të paragrafit 1., 2. të nenit 34 dhe paragrafit 1. të nenit 35 të këtij ligji;

4.6. kryen detyra të tjera të përcaktuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore për mbrojtjen e bimëve.

5. Inspekcioni fitosanitar i raporton periodikisht organit kompetent të Ministrisë mbi rezultatet e punës së tyre inspektuese nëpërmjet raporteve me shkrim gjashtë (6) mujore.

Neni 41 **Shpeshtësia e inspektimeve dhe kontrollimeve**

1. Inspektimet dhe kontrollimet e përcaktuara në nenin 40 të këtij ligji :

1.1. janë të lidhura me bimët, produktet bimore, që kultivohen apo përdoren nga prodhuesit, që janë të pranishme në territorin e tij dhe në tokat ku ato kultivohen;

1.2. preferohet të kryhen në vendin e prodhimit;

1.3. kryhen rregullisht në kohën e duhur, të paktën një herë në vit, me vrojtime vizuale, përveç kërkesave të veçanta të treguara në listën IV.

2. Kontrollimet dhe inspektimet mund të kryhen sipas rastit si vijon:

2.1. në çfarëdo kohë dhe vend atje ku qarkullohen bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera;

2.2. në mjediset ku bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera kultivohen, prodhohen, deponohen apo shiten, si dhe hapësirat punuese të klientëve;

2.3. në çdo kohë kryhen kontrollime të tjera për qëllime të tjera nga shëndeti i bimëve.

Neni 42

Inspektimet dhe kontrollet në pajtim me kërkesat e deklaruara fitosanitare

Nëse inspektimet e përcaktuara në nenin 40 të këtij ligji tregojnë se përmbushen kushtet e vendosura me këtë ligj, prodhuesi është i autorizuar që menjëherë të përdorë pasaportat bimore përkatëse për bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera në listën V.A.

Neni 43

Inspektimet dhe kontrollet të cilat nuk janë në pajtim me kërkesat e deklaruara fitosanitare

1. Përveç asaj që përcaktohet në paragrafin 2. të këtij neni, nëse si rezultat i inspektimit të paraparë në nenin 40 dhe të zbatuar në pajtim me nenin 41 të këtij ligji nuk janë përmbushur kushtet e kërkuara, nuk lëshohet autorizimi për përdorimin e pasaportës, ose nëse ai është lëshuar pezullohet apo anulohet.

2. Nëse pas inspektimit një pjesë e bimëve apo produkteve bimore të kultivuara, prodhuara apo të përdorura nga prodhuesi ose përndryshe të pranishme në mjediset e tij, ose kur një pjesë e tokës nuk përbën rrezik për përhapjen e organizmave të dëmshëm, dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni nuk do të zbatohet për pjesën në fjalë.

3. Nëse si rezultat i kontrolleve zyrtare të kryera në pajtim me nenin 41, bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera paraqesin rrezik për përhapjen e organizmave të dëmshëm, ato duhet t'u nënshtrohen masave zyrtare të përcaktuara në paragrafin 2. neni 44 i këtij ligji. Nëse dërgesat e tilla bimore vijnë nga jashtë, Ministria njofton vendin e interesuar masat që planifikon të marrë apo që i marrë tashmë, si përcaktohet në paragrafin 1. neni 44 i këtij ligji.

Neni 44

Masat zyrtare të vendosura nga inspektorët fitosanitarë

1. Kur vërtetohen shkeljet e dispozitave ligjore gjatë importimit të dërgesave, inspektori fitosanitar duhet të:

1.1. ndalojë importin e dërgesave dhe transferimin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, të cilat nuk i përmbushin kërkesat e përcaktuara si dhe të urdhërojë asgjësimin e tyre nëse gjenden organizma të dëmshëm që rrezikojnë shëndetin e bimëve;

1.2. urdhërojë trajtimin e duhur të dërgesave bimore, nëse konstatohet prania e organizmave të dëmshëm.

2. Për rastet e përcaktuara sipas paragrafit 1. neni 43 i këtij ligji, bimët, produktet bimore apo dheu në fjalë, iu nënshtrohen një apo më tepër masave zyrtare në vijim:

2.1. ndërprerje e pjesërishme apo e plotë e veprimtarisë prodhuese deri sa të vendoset se është eliminuar rreziku i përhapjes së organizmave të dëmshëm;

2.2. ndalimin i dorëzimit të dërgesës prodhuesit bujqësor derisa të kryhet kontrolli inspektues apo deri në rezultatet zyrtare nga ekzaminimi, hulumtimi dhe testimi;

2.3. lejimin e transferimit të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera që destinohen për përpunim, por nën mbikëqyrjen zyrtare të inspektorëve ;

2.4. lejimin i transferimit të kufizuar të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera në vende ku nuk ka rrezik për përhapjen e organizmave të dëmshëm, por nën mbikëqyrjen zyrtare të inspektorëve;

2.5. propozimin organit kompetent për çregjistrim, nëse personi i regjistruar nuk plotëson kërkesat e përcaktuara;

2.6. propozimin organit kompetent për pezullim apo anulim të përdorimit të pasaportës bimore;

2.7. vendosjen e masave administrative;

2.8. kryerjen e detyrave të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe akte të tjera nënligjore për mbrojtjen e bimëve.

3. Çfarëdo përgjegjësie që rrjedh nga zbatimi i masave të përcaktuara në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni duhet t'i ngarkohen personit përgjegjës.

KREU IX

GRUMBULLIMI, KËMBIMI, PËRDORIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMIMI

Neni 45

Burimet e të dhënave të nevojshme për qëllime fitosanitare

1. Organi kompetent për qëllime të analizimit dhe realizimit të masave në mbrojtjen e bimëve, mund të grumbulloi dhe përdorë të dhëna për nevojat e veta në pajtim me këtë ligj nga :

- 1.1. regjistri i prodhuesve dhe përpunuesve bujqësorë;
- 1.2. regjistri i subjekteve ekonomike;
- 1.3. regjistri tatimor - numri i tatimit;
- 1.4. numri, kufijtë, sipërfaqja e ngastrës, pronari dhe përdoruesi;
- 1.5. baza e të dhënave statistikore për toka bujqësore dhe toka pyjore, të dhënat mbi tokat në pronësi publike dhe qiramarrësit e këtyre tokave dhe pyjeve;
- 1.6. baza e të dhënave doganore për dërgesat bimore;
- 1.7. baza e të dhënave të Institutit Hidro-Meteorologjik të Kosovës;
- 1.8. Universitetet përkatëse dhe Institutet e akredituara hulumtuese;
- 1.9. të dhëna rajonale dhe komunale.

2. Të dhënat e grumbulluara nga paragrafi 1. i këtij neni mbahen nga organi kompetent apo subjekti i autorizuar nga Ministria.

3. Organi kompetent për mbrojtjen e bimëve mund të përdorë plane topografike, harta, pyetësor dhe plane ortofotografike digjitale.

4. Mënyra e lidhjes me bazat e tjera të të dhënave dhe metoda e marrjes së të dhënave rregullohen nga Ministria, me marrëveshje bashkëpunimi në pajtim me organet e tjera administrative përgjegjëse për bazën e të dhënave në kompetencë të tyre.

Neni 46

Këmbimi i të dhënave

1. Ministria u dërgon të dhënat nga regjistrat dhe bazat e të dhënave, organeve tjera të administratës, organeve lokale, për të plotësuar kërkesat e parapara me ligjet në fuqi, si dhe për të autorizuar persona juridik dhe ofrues të shërbimeve publike, për të kryer aktivitetet në lëmin e mbrojtjes së bimëve.

2. Organet administrative të cilat posedojnë bazën e të dhënave, harta, plane ortofotografike në pajtim me nenin 45 të këtij ligji, mund të këmbëjnë të dhënat me Ministrinë në bazë të një marrëveshje paraprake.

Neni 47

Menaxhimi i të dhënave

1. Organi kompetent nëpërmjet organeve administrative të Ministrisë mbledhë, ruan dhe publikon vazhdimisht të dhëna të cilat janë të lidhura me sistemim informativ në përdorim për nevoja të Ministrisë.

2. Organet administrative sigurojnë vendosjen dhe lidhjen e sistemit informativ sipas këtij neni me sistemin informativ të Ministrisë dhe me sistemin informativ ndërkombëtar në lëmin e mbrojtjes së bimëve, sipas nevojës.

3. Ministria me akt nënligjor përcakton mënyrën e lidhjes, kushtet për ruajtjen dhe mbajtjen e të dhënave në regjistrat, evidencat dhe bazën e të dhënave.

Neni 48 **Shkëmbimi i të dhënave në nivel ndërkombëtare**

1. Ministria shkëmben të dhëna në nivel ndërkombëtar për:
 - 1.1. kompetencat e organeve Qeveritare lidhur me mbrojtjen e shëndetit të bimëve;
 - 1.2. listën e pikave të hyrjes në të cilat lejohet importi i dërgesave bimore në Kosovë;
 - 1.3. listat e organizmave të dëmshëm;
 - 1.4. shënimet për hyrjen dhe praninë e organizmave të dëmshëm të përfshira në listat dhe të dhënat lidhur me zbatimin e masave fitosanitare;
 - 1.5. hyrjen, shumëzimin e pakontrolluar ose të dhëna për përhapjen e organizmave të dëmshëm të papërfshirë në lista, por të cilët paraqesin rrezik ekonomik potencial;
 - 1.6. hyrjen e organizmave të dëmshëm brenda një zone, e cila është shpallur si zonë e mbrojtur për ata organizma;
 - 1.7. raportet sistematike mbi rezultatet e vëzhgimeve në zonën mbrojtur;
 - 1.8. aktet nënligjore, të nxjerra në bazë të këtij ligji;
 - 1.9. konstatimin e organizmave të dëmshëm dhe regjistrimin e rasteve të kthimit apo asgjësimit të dërgesave nga importi për shkak të mos përmbushjes së kushteve shëndetësore;
 - 1.10. të dhënat dhe informacionet e tjera në pajtim me këtë ligj, në bazë të kërkesës së organit apo organizatës ndërkombëtare.
2. Të dhënat dhe informacionet e tjera mund të jepen në pajtim me konventat dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare.

KREU X **PROCEDURAT ADMINISTRATIVE**

Neni 49 **Kontrollet e dërgesave dhe shpenzimet për analizat laboratorike**

1. Shpenzimet e analizave laboratorike të dërgesave të kryera në bazë të kërkesës së inspektorit fitosanitar, për të vërtetuar gjendjen e shëndetit të bimëve barten nga importuesi.
2. Kur mostra është e infektuar, të gjitha shpenzimet e kontrollit të dërgesës që janë kryer në bazë të kërkesës së inspektorit fitosanitar për të verifikuar gjendjen shëndetësore të bimëve, i bart prodhuesi i bimëve tek i cili janë marrë mostrat.
3. Shpenzimet administrative për zbatimin e masave fitosanitare të ndërmarra në pajtim me këtë ligj për mbrojtjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, përveç rasteve të fuqisë madhore, i bart prodhuesi bujqësor.
4. Shpenzimet për lëshimin e certifikatave fitosanitare dhe pasaportave bimore, i bart paraqitësi i kërkesës.
5. Ministria me akt nënligjor e përcakton kontrollet inspektuese, vlera e taksës sipas llojit dhe sasisë së bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera si dhe mënyrën e pagesës.

Neni 50 **Kompensimet**

1. Nëse inspektori fitosanitar urdhëron marrjen e masave për zhdrukjen e organizmave dëmtues apo asgjësimin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera në pajtim me këtë ligj, prodhuesi i bimëve mund të marrë një kompensim të mundshëm nga organi kompetent me kusht që:

1.1. të ketë njoftuar në kohë shfaqjen apo dyshimin për praninë e organizmave të dëmshëm të përfshira në listat I.A. dhe II.A., ose në rast të zonave të mbrojtura, të organizmave të dëmshëm nga lista I.B. dhe II.B. të cilat janë nën kontroll zyrtar të përcaktuar me akt nënligjor të veçantë nga Ministria.

1.2. të ketë zbatuar të gjitha masat fitosanitare vazhdimisht dhe në kohë por ato nuk janë treguar të efektshme.

2. Kompensimin sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk paguhet, nëse organizmat e dëmshëm shfaqen në raste importi të dërgesave në Kosovë.

3. Kur vendimi për kompensim nuk merret ose nuk i dërgohet prodhuesit të bimëve brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga paraqitja e kërkesës për pagesën e kompensimit, prodhuesi bujqësor mund t'i kërkojë organit kompetent vlerësimin e dëmit me anë të padisë.

4. Ministria me akt nënligjor i përcakton kriteret për të drejtën në kompensim dhe shumën e kompensimit.

KREU XI PUNA E ORGANEVE PUBLIKE NË MBROJTJEN E BIMËVE

Neni 51 Puna e organeve publike

1. Punët me interes publik përfshijnë punët në përcjelljen, prognozën e shfaqjes të organizmave të dëmshëm, praninë e tyre dhe punët profesionale në lëmin e mbrojtjes së bimëve.

2. Punët për përcjelljen dhe prognozën përfshijnë:

2.1. monitorimin e organizmave të dëmshëm të pranishëm në bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera si dhe përcaktimin e afateve optimale për luftimin dhe asgjësimin e tyre;

2.2. identifikimin e shfaqjes dhe shumimin e organizmave të dëmshëm me karakter ekonomik;

2.3. identifikimin e organizmave të dëmshëm në fushë dhe laboratorë;

2.4. alarmimin dhe njoftimin e popullsisë dhe shërbimeve të tjera të rëndësishme për të parandaluar përhapjen e organizmave të dëmshëm, nëpërmjet këshillave, udhëzimeve dhe zbatimit të masave fitosanitare;

2.5. edukimin dhe trajnimin e prodhuesve në bujqësi për zbatimin e masave që lidhen me mbrojtjen e bimëve.

3. Veprimet teknike për mbrojtjen e bimëve janë:

3.1. kryerja e ekzaminimeve profesionale laboratorike në bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera për të diagnostikuar organizmat e dëmshëm;

3.2. shtim i aftësisë teknike të personave përgjegjës për mbrojtjen e bimëve;

3.3. lëshimi i pasaportave të bimëve;

3.4. veprimtaritë hulumtuese-shkencore dhe zhvillimore;

3.5. kryerja e punëve dhe detyrave tjera teknike që kërkohen në lëmin e mbrojtjes së bimëve.

3.6. dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin për nevojat e mbrojtjes së bimëve.

4. Ministria me akt nënligjor përcakton masat për dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin për nevojat e mbrojtjes së bimëve.

Neni 52 **Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve**

1. Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve janë:

- 1.1. organet përkatëse komunale,
- 1.2. laboratorë fitosanitar për diagnostikim të parazitëve në Institutin Bujqësor të Kosovës, Universitetet përkatëse si dhe laboratorë tjerë të akredituar;
- 1.3. shërbimi këshillimor për prodhimtarinë dhe mbrojtjen e bimëve, dhe
- 1.4. personat fizik dhe juridik të cilët i plotësojnë kushtet e parapara dhe që janë të regjistruar në Ministri.

2. Përjashtuar nga dispozitat e këtij neni, mbrojtja e bimëve pyjore kryhet në bashkëpunim nga organet institucionale, persona juridik dhe fizik të përcaktuar me ligje dhe akte të tjera nënligjore.

Neni 53 **Përgjegjësitë dhe financimi i institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve**

1. Përgjegjësitë e institucioneve të caktuara për mbrojtjen e bimëve janë:

- 1.1. zbatimi i punëve ose shërbimeve të vazhdueshme të autorizuara nga Ministria;
- 1.2. sigurimin e shërbimeve për prodhuesit e bimëve të përfshirë në mbrojtjen e bimëve dhe për personat e tjerë të interesuar sipas këtij ligji.

2. Financimi i ofruesve të shërbimeve në mbrojtjen e bimëve, bëhet nga:

- 2.1. pagesa e vlerës së shërbimeve nga përfituesit shfrytëzuesit edhe nëse disa shërbime mund të kryhen falas;
- 2.2. Buxheti i Qeverisë së Kosovës për kryerjen e punëve publike, për qëllime të caktuara.

3. Ministria me akt nënligjor përcakton përgjegjësitë dhe financimin e institucioneve të ngarkuar për mbrojtjen e bimëve.

Neni 54 **Mbikëqyrja profesionale**

Mbikëqyrja teknike e punëve me interes publik dhe inspektimeve fitosanitare, kryhen nga organi kompetent i Ministrisë, përveç mbrojtjen e bimëve në pylltari ku i njëjti funksion kryhet në pajtim me ligje dhe akte të tjera nënligjore në fuqi.

Neni 55 **Dhënia e autorizimeve**

Ministria lëshon autorizime për kryerjen e punëve me interes publik sipas paragrafit 1. neni 53 të këtij ligji, sipas kriterëve të përcaktuara.

Neni 56 **Detyrat dhe përgjegjësitë e Organit Kompetent**

1. Organi kompetent në Ministri kryen punë administrative dhe profesionale në mbrojtjen e bimëve dhe punë tjera të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

2. Organi kompetent në Ministri angazhohet për kryerjen e punëve në:

- 2.1. mbrojtjen e bimëve;
- 2.2. koordinimin dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet organit kompetent dhe bartësit e ofruesve të

shërbimeve publike;

2.3. raportimin e vendeve të tjera për çështje lidhur me mbrojtjen e bimëve;

2.4. grumbullimin i informatave për mbikëqyrje të përhershme të organizmave të dëmshëm, lidhur me vlerësimin e gjendjes shëndetësore të bimëve në vend dhe për ekzaminimet laboratorike për diagnostikimin e organizmave të dëmshëm që përfshihen në listat I.A., II.A., I.B. dhe II.B.;

2.5. vlerësimin e analizës së rrezikut të organizmave të dëmshëm;

2.6. hartimin e planeve teknike për përcaktimin e zonave ku kanë hyrë organizmat e dëmshëm dhe zonave të rrezikuara, të infektuara dhe të mbrojtura, kufizimin apo ndalimin e qarkullimit, importit ose kalimit transit të llojeve të veçanta të bimëve;

2.7. vendosjen dhe mbajtjen e regjistrave, evidencës dhe listave, përcaktimin e kufijve të zonave ku është i nevojshëm mbikëqyrje e veçantë;

2.8. përcjelljen e programit për parandalimin e përhapjes së organizmave të dëmshëm, dhe masat për luftimin dhe asgjësimin e tyre;

2.9. përgatitjen e raporteve, analizave, njoftimeve dhe materialeve të tjera për institucionet vendore dhe ndërkombëtare, të cilat Ministria duhet t'i informojë dhe të bashkëpunojë me to për përgatitjen e marrëveshjeve dhe kontratave ndërkombëtare për mbrojtjen e bimëve dhe zbatimin e tyre;

2.10. vendosjen dhe mbajtjen e sistemit të informimit për mbrojtjen e bimëve.

3. Për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen e organizmave të dëmshëm dhe për kontrollimin apo asgjësimin e tyre, nëse rrezikohet shëndeti i bimëve, Ministria me vendim:

3.1. ndalon kultivimin e llojeve të veçanta të bimëve dhe klonimin e tyre në një territor të caktuar dhe përcakton kufijtë e zonës nën mbikëqyrje;

3.2. siguron bashkëpunim mes prodhuesve të bimëve në rastet e kontrollimit dhe asgjësimit të organizmave të dëmshëm, dhe

3.3. merr masa emergjente dhe masa të tjera të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

KREU XII DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 57 Kundërvajtjet

1. Me gjobë prej pesëqind (500€) deri në një mijë e pesëqind (1.500€) Euro dënohet për kundërvajtje subjekti fizik dhe juridik, nëse:

1.1. fut në territor apo nuk respekton ndalimin e përhapjes, tregtimit dhe mbajtjes së organizmave të dëmshëm për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera apo kryhen shkelje të tjera të këtij ligji.

2. Me gjobë prej dyqind (200€) deri në pesëqind (500€) Euro dënohet për kundërvajtje çdo person që:

2.1. vepron në kundërshtim me nenin 6 të këtij ligji;

2.2. vepron në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji;

2.3. nuk kryen kontrole inspektuese të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera në pajtim me paragrafi 1. dhe 2 nenin 38. të këtij ligji;

2.4. nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga nënparagrafi 5.1. i paragrafit 5. neni 35 i këtij ligji;

2.5. vepron në kundërshtim me nënparagrafin 5.4. të paragrafit 5. të nenit 35 të këtij ligji;

2.6. nuk ruan pasaportën bimore në afatin kohor të përcaktuar nga paragrafi 2. i nenit 35 i këtij ligji;

2.7. jep të dhënat për përhapjen e organizmave të dëmshëm të konstatuara dhe nuk është i autorizuar për publikimin e të dhënave pa lejen e Ministrisë, sipas nenit 11 dhe 13 të këtij ligji.

3. Me gjobë nga pesëqind (500€) deri dymijë e pesëqind (2.500€) Euro dënohet për kundërvajtje çdo person që:

3.1. qarkullon bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera sipas nenit 16 dhe paragrafit 1. të nenit 37 të këtij ligji;

3.2. vepron në kundërshtim me nenin 37 dhe paragrafin 1. të nenit 38 të këtij ligji;

3.3. është i autorizuar të merret me fidanet dhe nuk lëshon pasaportën bimore duke shkelur nenet 32, 33 dhe 34 të këtij ligji;

3.4. vepron në kundërshtim me nenin 24 të këtij ligji;

3.5. importon dërgesa bimore në zonat e mbrojtura në kundërshtim me nenin 25 të këtij ligji;

3.6. nuk iu përgjigjet kërkesave të përcaktuara nga inspektori fitosanitar sipas paragrafit 2. neni 30 i këtij ligji;

3.7. vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi 1. neni 31 i këtij ligji.

4. Me gjobë nga njëmijë (1.000€) deri pesëmijë (5.000€) Euro dënohet për kundërvajtje personi që:

4.1. vepron në kundërshtim me nenin 19 të këtij ligji;

4.2. vepron në kundërshtim me nenin 14 të këtij ligji;

4.3. vepron në kundërshtim me paragrafët 1., 2., 3. dhe 4. të nenit 15 dhe me paragrafin 1. të nenit 16 të këtij ligji;

4.4. importon dërgesa të bimëve dhe produkteve bimore pa lejen e Ministrisë dhe vepron në kundërshtim me nënparagrafët 1.1 dhe 1.2. paragrafi 1. i nenit 23 të këtij ligji;

4.5. nuk zbaton masat sipas paragrafit 1. neni 26 i këtij ligji, të urdhëruara nga Inspekcioni fitosanitar ;

4.6. kryen punë me interes publik për mbrojtjen e bimëve në kundërshtim me nënparagrafin. 1.4. paragrafi 1. i nenit 52. të këtij ligji.

KREU XIII DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 58

1. Çështje të tjera lidhur me mbrojtjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera i referohen Ligjit për materialin fidanor dhe Ligjit për farëra.

2. Ndryshimet dhe plotësimet e listave për organizmat e dëmshëm për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera sipas neneve 7 dhe 8 të këtij ligji, të cilat trajtohen me akte nënligjore nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në harmoni me Direktivat e BE-së dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, duhet të zbatohen.

Neni 59

Anekset I deri VI janë pjesë përbërëse e këtij ligji.

**KREU XIV
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Neni 60

Të gjitha mjetet e grumbulluara në pajtim me këtë ligj do të derdhën në Buxhetin e Kosovës.

Neni 61

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji i nxjerr Ministria brenda afatit kohor prej dymbëdhjetë (12) muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 62
Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr.02/L-95 për Mbrojtjen e Bimëve dhe legjislacionin sekondar që buron nga ky ligj.

**Neni 63
Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-120
13 dhjetor 2012**

Shpallur me dekretin Nr. DL-064-2012, datë 28.12.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga

**LIGJI NR. 04/L-120
PËR MBROJTJEN E BIMËVE**

ANEKSI I

PJESA A

PARAZITE, HYRJA DHE PERHAPJA E TE CILEVE BRENDA TERRITORIT TE KOSOVES ESHTË E NDALUAR

SEKSIONI I

PARAZITE QE NUK JANE HASUR NE TERRITORIN E KOSOVËS

(a) Insekte, merimanga dhe nematoda, në të gjitha stadet e zhvillimit të tyre

1. *Acleris* spp. (jo European)
2. *Amauomyza maculosa* (Malloch)
3. *Anomala orientalis* Waterhouse
4. *Anoplophora chinensis* (Thomson)
 - 4.1. *Anoplophora glabripennis* (Motschulsky)
5. *Anoplophora malasiaca* (Forster)
6. *Arrhenodes minutus* Drury
7. *Bemisia tabaci* Genn., (populacione jo Europiane) vektor te viruseve te tilla si:
 - (a) Bean golden mosaic virus
 - (b) Cowpea mild mottle virus
 - (c) Lettuce infectious yellows virus
 - (d) Pepper mild tigré virus
 - (e) Squash leaf curl virus
 - (f) Euphorbia mosaic virus
 - (g) Florida tomato virus
8. *Cicadellidae* (jo-Europiane) te njohura si vektorë të sëmundjes Pierce's disease (shkaktuar nga *Xylella fastidiosa*) të tilla si:
 - a) *Carneocephala fulgida* Nottingham
 - b) *Draeculacephala minerva* Ball
 - c) *Graphocephala atropunctata* (Signoret)
9. *Choristoneura* spp. (jo-Europiane)
10. *Conotrachelus nenuphar* (Herbst)
 - 10.1 . *Diabrotica barberi* Smith & Lawrence
 - 10.2 . *Diabrotica undecimpunctata howardi* Barber
 - 10.3 . *Diabrotica undecimpunctata undecimpunctata* Mannerheim
 - 10.4 . *Diabrotica virgifera* Le Conte
11. *Globodera pallida* (Stone) Behrens
 - 11.1 . *Globodera rostochiensis* (Wollenweber) Behrens
12. *Heliothis zea* (Boddie)
 - 12.1. *Hirschmanniella* spp., perveç *Hirschmanniella gracilis* (de Man) Luc & Goodey
 - 12.2 *Liriomyza sativae* Blanchard

13. *Longidorus diadecturus* Eveleigh and Allen
14. *Meloidogyne chitwoodi* Golden et al. (gjithe popullatat)
 - 14.1. *Meloidogyne fallax* Karszen
 - 14.2. *Monochamus* spp. (jo-Europiane)
15. *Myndus crudus* Van Duzee
16. *Nacobbus aberrans* (Thorne) Thorne et Allen
 - 16.1. *Naupactus leucoloma* Boheman
17. *Opogona sacchari* (Bojer)
18. *Popilia japonica* Newman
19. *Premnotypes* spp. (jo-Europiane)
20. *Pseudopithyophthorus minutissimus* (Zimmermann)
21. *Pseudopithyophthorus pruinosus* (Eichhoff)
22. *Rhizoecus hibisci* Kawai and Takagi
23. *Scaphoideus luteolus* (Van Duzee)
24. *Spodoptera eridania* (Cramer)
25. *Spodoptera frugiperda* (Smith)
26. *Spodoptera littoralis* (Boisduval)
27. *Spodoptera litura* (Fabricius)
28. *Thrips palmi* Karny
29. *Tephritidae* (jo-Europiane) te tilla si:
 - (a) *Anastrepha fraterculus* (Wiedemann)
 - (b) *Anastrepha ludens* (Loew)
 - (c) *Anastrepha obliqua* Macquart
 - (d) *Anastrepha suspensa* (Loew)
 - (e) *Dacus ciliatus* Loew
 - (f) *Dacus cucurbitae* Coquillett
 - (g) *Dacus dorsalis* Hendel
 - (h) *Dacus tryoni* (Froggatt)
 - (i) *Dacus tsuneonis* Miyake
 - (j) *Dacus zonatus* Saund.
 - (k) *Epochra canadensis* (Loew)
 - (l) *Pardalaspis cyanescens* Bezzi
 - (m) *Pardalaspis quinaria* Bezzi
 - (n) *Pterandrus rosa* (Karsch)
 - (o) *Rhacochlaena japonica* Ito
 - (p) *Rhagoletis cingulata* (Loew)
 - (q) *Rhagoletis completa* Cresson
 - (r) *Rhagoletis fausta* (Östen-Sacken)
 - (s) *Rhagoletis indifferens* Curran
 - (t) *Rhagoletis mendax* Curran
 - (u) *Rhagoletis pomonella* Walsh
 - (v) *Rhagoletis ribicola* Doane
 - (w) *Rhagoletis suavis* (Loew)
30. *Xiphinema americanum* Cobb *sensu lato* (popullata jo Europiane)
31. *Xiphinema californicum* Lamberti et Blevè-Zacheo

(b) **Bakterie**

1. *Clavibacter michiganensis* (Smith) Davis et al. ssp. *sepedonicus* (Spieckermann and Kotthoff) Davis et al.
2. *Pseudomonas solanacearum* (Smith) Smith
3. *Ralstonia solanacearum* (Smith) Yabuuchi et al.
4. *Xylella fastidiosa* (Wells et Raju)
5. *Xylophilus ampelinus* (Panagopoulos) Willems et al.

(c) **Kërpudha**

1. *Ceratocystis fagacearum* (Bretz) Hunt
2. *Chrysomyxa arctostaphyli* Dietel
3. *Cronartium* spp. (jo- Europiane)
4. *Endocronartium* spp. (jo-Europiane)
5. *Guignardia loricata* (Saw.) Yamamoto et Ito
6. *Gymnosporangium* spp. (jo-Europiane)
7. *Inonotus weirii* (Murrill) Kotlaba et Pouzar
8. *Melampsora farlowii* (Arthur) Davis
9. *Melampsora medusae* Thumen
10. *Monilinia fructicola* (Winter) Honey
11. *Mycosphaerella larici leptolepis* Ito et al.
12. *Mycosphaerella populorum* G.E. Thompson
13. *Phoma andina* Turkensteen
14. *Phyllosticta solitaria* Ell. et Ev.
15. *Septoria lycopersici* Speg. var. *malagutii* Ciccarone et Boerema
16. *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival
17. *Thecaphora solani* Barrus
18. *Tilletia indica* Mitra
- Trechispora brinkmannii* (Bresad.) Rogers

(d) **Viruse dhe organizma të ngjajshme si viruse**

1. Elm phloem necrosis mycoplasma
2. Viruset e patates dhe organizma si-viruset të tilla si:
 - (a) Andean potato latent virus
 - (b) Andean potato mottle virus
 - (c) Arracacha virus B, oca strain
 - (d) Potato black ring spot virus
 - (e) Potato spindle tuber viroid
 - (f) Potato virus T
 - (g) Izolate jo Europiane të viruseve të patates A, M, S, V, X dhe Y (përfshirë Y^o, Yⁿ dhe Y^c) dhe Potato leaf roll virus
3. Tobacco ring spot virus
4. Tomato ring spot virus
5. Viruse dhe organizma si-viruse tek *Cydonia* Mill., *Fragaria* L., *Malus* Mill., *Prunus* L., *Pyrus* L., *Ribes* L., *Rubus* L. and *Vitis* L., të tilla si:
 - (a) Blueberry leaf mottle virus
 - (b) Cherry rasp leaf virus (Amerikan)
 - (c) Peach mosaic virus (Amerikan)
 - (d) Peach phony rickettsia
 - (e) Peach rosette mosaic virus
 - (f) Peach rosette mycoplasma
 - (g) Peach X-disease mycoplasma
 - (h) Peach yellows mycoplasma
 - (i) Pear decline mycoplasma

- (j) Plum line pattern virus (Amerikan)
- (k) Raspberry leaf curl virus (Amerikan)
- (l) Strawberry latent "C" virus
- (m) Strawberry vein banding virus
- (n) Strawberry witches' broom mycoplasma
- (o) Viruse dhe organizma si-viruse, jo Europiane, te *Cydonia* Mill., *Fragaria* L., *Malus* Mill., *Prunus* L., *Pyrus* L., *Ribes* L., *Rubus* L. and *Vitis* L.

6. Viruse te transmetuara nga *Bemisia tabaci* Genn., të tilla si:

- (a) Bean golden mosaic virus
- (b) Cowpea mild mottle virus
- (c) Lettuce infectious yellows virus
- (d) Pepper mild tigré virus
- (e) Squash leaf curl virus
- (f) Euphorbia mosaic virus
- (g) Florida tomato virus

(e) **Bimë parazitë**

- 1. *Arceuthobium* spp. (jo-European)

Seksioni II

PARAZITE QE JANE HASUR NE TERRITORIN E KOSOVËS

- (a) **Insekte, këpurdha dhe nematoda, në të gjitha stadet e zhvillimit të tyre**
1. *Diabrotica virgifera virgifera* Le Conte
- (b) **Bakterie**
1. *Clavibacter michiganensis* (Smith) Davis et al. Ssp. *Sepedonicus* (Spickermann and Kothof) Davis et.al.
- (c) **Kërpudha**
1. *Melampsora medusae* Thumen
- (d) **Viruse dhe organizma të ngjajshme si viruse**
1. Pear decline mycoplasma

PJESA B

PARAZITE, HYRJA DHE PERHAPJA E TE CILEVE BRENDIA ZONAVE TE PASTRA TE CAKTUARA, ESHTË E NDALUAR

(a) **Insekte, këpudha dhe nematoda, në të gjitha stadet e zhvillimit të tyre**

Speciet	Zona e paster
1. <i>Bemisia tabaci</i> Genn. (Popullata Europiane)	
1.1. <i>Daktulosphaira vitifoliae</i> (Fitch)	
3. <i>Leptinotarsa decemlineata</i> Say	
4. <i>Liriomyza bryoniae</i> (Kaltenbach)	

(b) **Viruse dhe organizma të ngjajshme si viruse**

Speciet	Zona e paster
1. Beet necrotic yellow vein virus.	
2. Tomato spotted wilt virus.	

ANEKSI II

PJESA A

PARAZITE, HYRJA DHE PERHAPJA E TE CILEVE BRENDA TERRITORIT TE KOSOVËS ESHTË E NDALUAR, NE SE ATO GJENDEN NE BIME OSE PRODUKTE BIMORE TE CAKTUARA

Seksioni I

PARAZITE QE NUK JANE HASUR NE TERRITORIN E KOSOVËS

Insekte, merimanga dhe nematoda, në të gjitha stadet e zhvillimit të tyre

Speciet	Subjektet që kontaminohen
1. <i>Aculops fuchsiae</i> Keifer	Bimet e <i>Fuchsia</i> L., te planifikuara per mbjellje, te ndryshme nga farat
2. <i>Aleurocanthus</i> spp.	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat dhe farat
3. <i>Anthonomus bisignifer</i> (Schenkling)	Bimet e <i>Fragaria</i> L., per mbjellje, te ndryshme nga farat
4. <i>Anthonomus signatus</i> (Say)	Bimet e <i>Fragaria</i> L., per mbjellje, te ndryshme nga farat
5. <i>Aonidiella citrina</i> Coquillet	<i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat dhe farat
6. <i>Aphelenchoides besseyi</i> Christie	Farat e <i>Oryza</i> spp. Bimet e <i>Fragaria</i> L., te planifikuara per mbjellje, te ndryshme nga farat.
7. <i>Aschistonyx eppoi</i> Inouye	Bimet <i>Juniperus</i> L., te ndryshme nga frutat dhe farat , me origjine nga vendet jo Europiane
8. <i>Bursaphelenchus xylophilus</i> (Steiner et Bühner) Nickle et al.	Bimet e <i>Abies</i> Mill., <i>Cedrus</i> Trew, <i>Larix</i> Mill., <i>Picea</i> A. Dietr., <i>Pinus</i> L., <i>Pseudotsuga</i> Carr. and <i>Tsuga</i> Carr., te ndryshme nga frutat dhe farerat, dhe druri i Konifereve (<i>Coniferales</i>), me origjine nga vendet jo Europiane
9. <i>Carposina niponensis</i> Walsingham	Bimet e <i>Cydonia</i> Mill., <i>Malus</i> Mill., <i>Prunus</i> L. dhe <i>Pyrus</i> L., te ndryshme nga farat, me origjine nga vendet jo-Europiane
10. <i>Cephalcia larichifila</i> (klug)	Bimët e <i>Larix</i> Mill. Të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
11. <i>Circulifer haematoceps</i>	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat e farat.
12. <i>Circulifer tenellus</i>	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat e farat.
13. <i>Diaphorina citri</i> Kuway	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre; dhe <i>Murraya</i> König, te ndryshme nga frutat dhe farerat
14. <i>Enarmonia packardi</i> (Zeller)	Bimet e <i>Cydonia</i> Mill., <i>Malus</i> Mill., <i>Prunus</i> L. dhe <i>Pyrus</i> L., te ndryshme nga farat, me origjine nga vendet jo-Europiane
15. <i>Enarmonia prunivora</i> Walsh	Bimet e <i>Crataegus</i> L., <i>Malus</i> Mill., <i>Photinia</i> Ldl., <i>Prunus</i> L. dhe <i>Rosa</i> L., te planifikuara per mbjellje, te ndryshme nga farerat, dhe frutat e <i>Malus</i> Mill. dhe <i>Prunus</i> L., me origjine nga vendet jo-Europiane
16. <i>Eotetranychus lewisi</i> McGregor	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat dhe farat.
17. <i>Eutetranychus orientalis</i> Klein	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat e farat.
18. <i>Grapholita inopinata</i> Heinrich	Bimet e <i>Cydonia</i> Mill., <i>Malus</i> Mill., <i>Prunus</i> L. dhe <i>Pyrus</i> L., te ndryshme nga farat, me origjine nga vendet jo-Europiane
19. <i>Hishomonus phycitis</i>	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat dhe farat
20. <i>Leucaspis japonica</i> Ckll.	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat dhe farat
21. <i>Listronotus bonariensis</i> (Kuschel)	Farat e <i>Cruciferae</i> , <i>Gramineae</i> dhe <i>Trifolium</i> spp., me origjine

	nga Argjentina, Australia, Bolivia, Kili, Zealanda e Re dhe Uruguai.
22. <i>Margarodes</i> , speciet jo-Europiane, te tilla si : (a) <i>Margarodes vitis</i> (Phillipi) (b) <i>Margarodes vredendalensis</i> de Klerk (c) <i>Margarodes prieskaensis</i> Jakubski	Bimet e <i>Vitis</i> L., te ndryshme nga frutat dhe farat
23. <i>Numonia pyrivorella</i> (Matsumura)	Bimet e <i>Pyrus</i> L., te ndryshme nga farat, me origjine nga vendet jo-Europiane
24. <i>Oligonychus perditus</i> Pritchard et Baker	Bimet e <i>Juniperus</i> L., te ndryshme nga frutat dhe farat, me origjine nga vendet jo-Europiane
25. <i>Pissodes</i> spp. (jo-Europiane)	Bimet e konifereve (<i>Coniferales</i>) te ndryshme nga frutat dhe farat, druri i konifereve (<i>Coniferales</i>) me lekure, dhe lekura e vecuar e konifereve (<i>Coniferales</i>), me origjine nga vendet jo-Europiane
26. <i>Radopholus citrophilus</i> Huettel Dickson et Kaplan	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre te ndryshme nga frutat dhe farat, dhe bimet e <i>Araceae</i> , <i>Marantaceae</i> , <i>Musaceae</i> , <i>Persea</i> spp., <i>Strelitziaceae</i> , te rrenjezuara ose me terren mbjelles te bashkangjitur ose shoqerues
27. <i>Radopholus similis</i> (Cobb) Thorne	Bimet e <i>Araceae</i> , <i>Marantaceae</i> , <i>Musaceae</i> , <i>Persea</i> spp., <i>Strelitziaceae</i> , te rrenjezuara ose me terren rrites te bashkuara ose te shoqeruara.
28. <i>Saissetia nigra</i> (Nietm.)	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat dhe farat
29. <i>Scirtothrips aurantii</i> Faure	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga farat
30. <i>Scirtothrips dorsalis</i> Hood	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat dhe farat
31. <i>Scirtothrips citri</i> (Moultx)	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga farat
32. <i>Scolytidae</i> spp. (specie jo-Europiane)	Bimet e konifereve (<i>Coniferales</i>), mbi 3 m ne gjatesi, te ndryshme nga frutat dhe farat, druri i konifereve (<i>Coniferales</i>) me lekure, dhe lekura e vecuar e konifereve (<i>Coniferales</i>), me origjine nga vendet jo-Europiane
33. <i>Tachypterellus quadrigibbus</i> Say	Bimet e <i>Cydonia</i> Mill., <i>Malus</i> Mill., <i>Prunus</i> L. dhe <i>Pyrus</i> L., te ndryshme nga farat, me origjine nga vendet jo-Europiane
34. <i>Toxoptera citricida</i> Kirk.	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat dhe farat
35. <i>Trioza erytrae</i> Del Guercio	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, dhe <i>Clausena</i> Burm.f., te ndryshme nga frutat dhe farat
36. <i>Unaspis citri</i> Comstock	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat dhe farat

(b) Baktere

Speciet	Subjektet që kontaminohen
1. Citrus greening bacterium	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat dhe farat
2. Citrus variegated chlorosis	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga frutat dhe farat
3. <i>Clavibacter michiganensis</i> spp. <i>insidiosus</i> (McCulloch) Davis et al.	Farat e <i>Medicago sativa</i> L.
4. <i>Curtobacterium flaccumfaciens</i> pv. <i>flaccumfaciens</i> (Hedges) Collins and Jones	Farat e <i>Phaseolus vulgaris</i> L. dhe <i>Dolichos</i> Jacq.

5. <i>Erwinia stewartii</i> (Smith) Dye	Farat e <i>Zea mais</i> L.
6. <i>Erwinia chrysanthemi</i> pv. <i>dianthicola</i> (Hellmers) Dickey	Bimët e <i>Dianthus</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
7. <i>Pseudomonas caryophylli</i> (Burkholder) Starr et Burkholder	Bimët e <i>Dianthus</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
8. <i>Pseudomonas syringae</i> pv. <i>persicae</i> (Prunier et al.) Young et al.	Bimët e <i>Prunus persica</i> (L.) Batsch dhe <i>Prunus persica</i> var. <i>nectarina</i> (Ait.) Maxim, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
9. <i>Xanthomonas campestris</i> (të gjitha shtamet patogjenike mbi Citrus)	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga farat
10. <i>Xanthomonas campestris</i> pv. <i>Oryzae</i> (Ishiyama) Dye dhe pv. <i>oryzicola</i> (Fang et al.) Dye	Farat e <i>Oryza</i> spp me origjinë nga vendet jo-Europiane.,
11. <i>Xanthomonas campestris</i> pv. <i>Phaseoli</i> (Smith) Dye	Farat e <i>Phaseolus</i> L.
12. <i>Xanthomonas campestris</i> pv. <i>pruni</i> (Smith) Dye	Bimët e <i>Prunus</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
13. <i>Xylophilus ampelinus</i> (Panagopoulos) Willems et al.	Bimët e <i>Vitis</i> L., të ndryshme nga frutat dhe farat

(c) Kërpudha

Speciet	Subjektet që kontaminohen
1. <i>Alternaria alternata</i> (Fr.) Keissler (isolatet patogjenike jo-Europiane)	Bimët e <i>Cydonia</i> Mill., <i>Malus</i> Mill. and <i>Pyrus</i> L., te planifikuara per mbjelle, te ndryshme nga farat, me origjine nga vendet jo-Europiane
1.1. <i>Anisogramma anomala</i> (Peck) E. Müller	Bimët e <i>Corylus</i> L., te planifikuara per mbjellje, te ndryshme nga farat, me origjine nga Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara te Amerikes
2. <i>Apiosporina morbosa</i> (Schwein.) v. Arx	Bimët e <i>Prunus</i> L., te planifikuara per mbjellje, te ndryshme nga farat
3. <i>Atropellis</i> spp.	Bimët e <i>Pinus</i> L., te ndryshme nga frutat dhe farat, lekuara e vecuar dhe druri i <i>Pinus</i> L.
4. <i>Ceratocystis coerulea</i> (Münch) Bakshi	Bimët e <i>Acer saccharum</i> Marsh., të ndryshme nga frutat dhe farat, me origjinë nga vendet e Amerikës së Veriut, druri i <i>Acer saccharum</i> Marsh., përfshirë drurin që nuk ka sipërfaqen e tij natyrale, me origjinë nga vendet e Amerikës së Veriut
5. <i>Ceratocystis fimbriata</i> f. spp. <i>platani</i> Walter	Bimët e <i>Platanus</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, dhe druri i <i>Platanus</i> L., përfshirë drurin qe nuk ka ruajtur sipërfaqen e tij natyrale të rrumbullakët.
6. <i>Ceratocystis virescens</i> (Davidson) Moreau	Bimët e <i>Acer saccharum</i> Marsh., te ndryshme nga frutat dhe farat, me origjine nga SH.B.A. dhe Kanadaja, druri i <i>Acer saccharum</i> Marsh., perfshire drurin i cili nuk ka sipërfaqen e tij natyrale te rrumbullaket, me origjine nga SH.B.A. dhe Kanadaja.
7. <i>Cercoseptoria pini-densiflorae</i> (Hori and Nambu) Deighton	Bimët e <i>Pinus</i> L., te ndryshme nga frutat dhe farat, dhe druri i <i>Pinus</i> L.
8. <i>Cercospora angolensis</i> Carv. and Mendes	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, te ndryshme nga farat
9. <i>Ciborinia camelliae</i> Kohn	Bimët e <i>Camellia</i> L., te planifikuara per mbjellje, te ndryshme nga farat, me origjine nga vendet jo-Europiane
10. <i>Colletotrichum acutatum</i> Simmonds	Bimët e <i>Fragaria</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
11. <i>Diaporthe vaccinii</i> Shaer	Bimët e <i>Vaccinium</i> spp., te planifikuara per mbjellje, te ndryshme nga farat
12. <i>Didymella ligulicola</i> (Baker,	Bimët e <i>Dendranthema</i> (DC.) Des Moul., të planifikuara për

Dimock and Davis) v. Arx	mbjellje, të ndryshme nga farat.
13. <i>Elsinoe</i> spp. Bitanc. and Jenk. Mendes	Bimet e <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat, dhe bimët e <i>Citrus</i> L. dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga farat dhe frutat përcjellur nga frutave të <i>Citrus reticulata</i> Blanco dhe të <i>Citrus sinensis</i> (L.) Osbeck, me origjinë nga Amerika e Jugut
14. <i>Fusarium oxysporum</i> f. sp. <i>Albedinis</i> (Kilian and Maire) Gordon	Bimet të <i>Phoenix</i> spp., të ndryshme nga frutat dhe farat
15. <i>Guignardia citricarpa</i> Kiely (të gjitha shtamet patogjenike mbi bimët Citrus)	Bimet e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga farat
16. <i>Guignardia piricola</i> (Nosa) Yamamoto	Bimet e <i>Cydonia</i> Mill., <i>Malus</i> Mill., <i>Prunus</i> L. dhe <i>Pyrus</i> L., të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet jo-Europiane
17. <i>Hypoxyton mammatum</i> (Wahl.) J.Miller	Bimet e <i>Populus</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
18. <i>Phialophora cinerescens</i> (Wollenweber) van Beyma	Bimët e <i>Dianthus</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
19. <i>Phoma tracheiphila</i> (Petri) Kanchaveli and Gikashvili	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga farat.
20. <i>Phytophthora fragariae</i> Hickmann var. <i>fragariae</i>	Bimët e <i>Fragaria</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
21. <i>Puccinia pittieriana</i> Hennings	Bimet <i>Solanaceae</i> , të ndryshme nga frutat dhe farat.
22. <i>Scirrhia acicola</i> (Dearn.) Siggers	Bimet e <i>Pinus</i> L., të ndryshme nga frutat dhe farat
23. <i>Venturia nashicola</i> Tanaka and Yamamoto	Bimet e <i>Pyrus</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet jo-Europiane

(d) Viruse dhe organizma të ngjajshme si viruse

Speciet	Subjektet që kontaminohen
1. Arabis mosaic virus	Bimët e <i>Fragaria</i> L. and <i>Rubus</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
2. Beet curly top virus (isolate jo-Europiane)	Bimët e <i>Beta vulgaris</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
3. Beet leaf curl virus	Bimët e <i>Beta vulgaris</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
4. Black raspberry latent virus.	Bimët e <i>Rubus</i> L., të planifikuara për mbjellje
5. Blight and blight-like	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
6. Cadang-Cadang viroid	Bimët e <i>Palmae</i> , të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet jo-Europiane
7. Cherry leafroll virus	Bimët e <i>Rubus</i> L., të planifikuara për mbjellje
8. Citrus mosaic virus.	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
9. Chrysanthemum stunt viroid	Bimët e <i>Dendranthema</i> (DC.) Des Moul., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
10. Citrus tristeza virus (izolatet jo-Europiane)	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat.
11. Citrus vein enation woody gall	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat.
12. Grapevine flavescence dorée MLO	Bimët e <i>Vitis</i> L., të ndryshme nga frutat dhe farat.
13. Leprosis	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
14. Little cherry pathogen (izolatet jo-Europiane)	Bimët e <i>Prunus cerasus</i> L., <i>Prunus avium</i> L., <i>Prunus incisa</i> Thunb., <i>Prunus sargentii</i> Rehd., <i>Prunus serrula</i> Franch., <i>Prunus serrulata</i> Lindl., <i>Prunus speciosa</i> (Koidz.) Ingram, <i>Prunus subhirtella</i> Miq., <i>Prunus yedoensis</i> Matsum., dhe hibridet dhe kultivarët e tyre, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat

15. Naturally spreading psorosis.	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
16. Palm lethal yellowing mycoplasma.	Bimët e <i>Palmae</i> , të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet jo-Europiane
17. Prunus necrotic ringspot virus	Bimët e <i>Rubus</i> L., të planifikuara për mbjellje
18. Raspberry ringspot virus	Bimët e <i>Fragaria</i> L. dhe <i>Rubus</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
19. Satsuma dwarf virus.	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
20. <i>Spiroplasma citri</i> Saglio et al.	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat.
21. Strawberry crinkle virus	Bimët e <i>Fragaria</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
22. Strawberry latent ringspot virus	Bimët e <i>Fragaria</i> L. dhe <i>Rubus</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
23. Strawberry mild yellow edge virus	Bimët e <i>Fragaria</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
24. Tatter leaf virus.	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
25. Tomato black ring virus	Bimët e <i>Fragaria</i> L. dhe <i>Rubus</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
26. Tomato spotted wilt virus	Bimët e <i>Apium graveolens</i> L., <i>Capsicum annuum</i> L., <i>Cucumis melo</i> L., <i>Dendranthema</i> (DC.) Des Moul., të gjitha varjetet e hibrideve të Guinesë së Re <i>Impatiens</i> , <i>Lactuca sativa</i> L., <i>Lycopersicon lycopersicum</i> (L.) Karsten ex Farw. <i>Nicotiana tabacum</i> L., për të cilat është evidentuar që ato janë planifikuar për shitje për prodhim profesional të duhanit. <i>Solanum melongena</i> L. dhe <i>Solanum tuberosum</i> L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
27. Tomato yellow leaf curl virus	Bimët e <i>Lycopersicon lycopersicum</i> (L.) Karsten ex Farw., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
28. Witches' broom (MLO).	Bimët e <i>Citrus</i> L., <i>Fortunella</i> Swingle, <i>Poncirus</i> Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat

Seksioni II PARAZITE QE JANE HASUR NE TERRITORIN E KOSOVËS

(a). Insekte, këpusha dhe nematoda, në të gjitha stadet e zhvillimit të tyre

Speciet	Subjektet që kontaminohen
1. <i>Anthonomus grandis</i> (Boh.)	Fara dhe fruta (boce) <i>Gossypium</i> spp. dhe pambuk te pa c'veshur
